

HARUN JAHJA



**TË MËSOJMË
ISLAMIN
TONË**



Të dashur fëmijël

Ky libër flet për fuqinë e Allahut, i Cili krijoi mamën, babin, shokët, gjithë njerëzit e tjerë, kafshët, bimët, dhe të gjithë gjallesat e tjera, tokën, diellin, hënën dhe gjithë universin. Ai tregon për fuqinë dhe diturinë e pamatë të Zotit tonë dhe na mëson se si dëshiron Zoti ynë që të sillemi dhe çfarë e zemëron Ai. Mos harroni! Këto janë gjëra shumë të rëndësishme, të cilat do t'ju sjellin përparimin!

DY FJALË RRETH AUTORIT



I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për

besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne





Shtëpia Botuese "Furkan ISM"
Brigada II Maqedonase, lokali 22
1000 Shkup, Maqedoni



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٌ





TË MËSOJMË ISLAMIN TONË



Dy fjalë rreth autorit dhe veprave të tij

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate



(Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeya kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

Të dashur fëmijë

o Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre të efektshme dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

o Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfituar nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

o Një shërbim i madh për Islamin do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

o Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

o Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjanuar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumenta të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe devijime në zemrat e tyre.

HARUN JAHJA

TË MËSOJME
ISLAMIN TONË



Shtëpia Botuese "Furkan ISM"
Brigada II Maqedonase,
lokali 22 1000 Shkup, Maqedoni



PËRMBAJTJA

HYRIE	10
TË GJITHË NE JEMI KRUESA TË ALLAHUT	12
Si u krijua njeriu?	16
Programi i përsosur në trupin e njeriut	22
Si u Krijuan Qeniet e Tjera të Gjalla?	27
Krijimi i Universit	34
Allahu është Ai, i Cili krijoi çdo gjë	43
Allahu krijoi çdo njeri me një fat të caktuar	44
ALLAHU DËRGOI PROFETËT DHE LIBRAT	48
Njeriu dhe i dërguari i parë: Ademi	55
Armiku më i madh i njeriut: Djalli	59
Profeti Nuh (Noa)	61
Profeti Ibrahim (Abraham)	66
Profeti Musa (Moisi)	70
Profeti Junus (Jona)	77
Profeti Jusuf (Jozef)	79
Profeti Ejub (Jobi)	81
Profeti Isa (Jezusi)	82
I Dërguari i Allahut: Muhammedi	86

MREKULLITË E KUR'ANIT	91
Si ka lindur universi	92
Orbitat	92
Detet nuk përzihen me njëri tjetrin	94
Rrumbullakësia e tokës	94
Gjurmët e gishtërinjve	96
ÇFARË KARAKTERI DËSHIRON ALLAHU PËR NE?	99
Dashuria ndaj Allahut dhe Mbështetja tek Ai	100
Si duhet të sillemi me njerëzit e tjerë?	106
ADHUROJENI ALLAHUN	113
Lutja është mënyrë që t'i afrohemi Allahut	118
VDEKJA DHE JETA NË BOTËN E PËRTEJME	127
Si duhet ta mendojmë vdekjen?	127
Bota e Përtejme	128
Parajsa dhe Zjarri	129
Telashet e kësaj bote na bëjnë të kuptojmë më mirë	
bukurinë e xhennetit	130
Dënimi në Zjarr do të zgjasë përjetësisht	140
PËRFUNDIM	144





HYRJE

Të dashur fëmijë! Në këtë libër do të flasim për gjëra të rëndësishme, rreth të cilave duhet të mendoheni thellë...

Në shkollë, së pari mësuesit iu mësojnë alfabetin. Pastaj vijnë numrat dhe mësimet e matematikës. Por, a keni menduar ndonjëherë, pse duhet të shkoni në shkollë për të mësuar gjithë këto gjëra?

Shumë prej jush mund të përgjigjeshin se, këto gjëra janë të domosdoshme në mënyrë që të fitoni një profesion për të qenë kur të rriteni. Kjo, do të thotë se jeni gati të sigurtë se do të rriteni një ditë. Në të vërtetë, ajo ditë do të vijë kur fëmijët do të fillojnë t'iu thërrasin, "Dajë, hallë apo gjysh..." njësoj sikur ju, tani i thërrisni dajallarët,

hallat apo gjyshërit tuaj. Me fjalë të tjera, një ditë do të rriteni, nëse këtë gjë e ka caktuar Allahu.

Sidoqoftë, nuk do të rriteni pa ndërprerë. Njerëzit rriten gradualisht, por, kur vjen dita, ata e lënë këtë botë dhe fillojnë jetën e re në botën e përtejme. Po kështu do të ndodhë edhe me ju. Pas ditëve të fëmijërisë, do të bëheni të rinj e pastaj, do të arrini moshën e gjyshërve tuaj. Pastaj, do të vijë koha kur do të filloni jetën e përtejme.

Ju shkoni në shkollë që të përgatiteni për të ardhmen. Për çdo njeri është e rëndësishme që të bëjë përgatitje të tilla. Megjithatë, të gjitha këto përpjekje janë të kufizuara vetëm për këtë botë. Po pajimet që ju duhen për botën tjetër? Duhet që të përgatiteni gjithashtu edhe për botën e përtejme. A ju ka rënë ndërmend ndonjëherë një gjë e tillë?

Kur të rriteni, duhet që të fitoni për të jetuar, do të thotë, ju nevojitet një profesion. Për këtë gjë duhet shkuar në shkollë. Ngjashëm, për të jetuar jetë të lumtur në jetën e përtejme, duhen bërë disa gjëra të caktuara. Gjëja kryesore është që, të filloni të njihni Allahun, Zotin tonë të Madhëruar, dhe si Ai kërkon që të sillemi ne.

Në këtë libër, do të flasim për fuqinë e Allahut, i Cili krijoi nënën tënde, babain, të gjithë njerëzit e tjerë, kafshët, bimët, shkurtimisht, të gjitha qeniet e gjalla, tokën, diellin, hënën dhe tërë gjithësinë. Do të flasim për fuqinë dhe diturinë e pamatë të Zotit tonë dhe çfarë na ka lejuar dhe çfarë na ka ndaluar. Mos harroni se, këto janë gjëra shumë të rëndësishme, të cilat do t'iu sjellin shumë dobi në të ardhmen!



TË GJITHË NE JEMI KRIJESA TË ALLAHUT

Shpesh dëgjoni njerëzit duke e përmendur Allahun. Ata zakonisht e thonë këtë në formë të fjalive si: “Allahu të begatofte!” apo “Në dashtë Allahu”, “Insha'Allah” “Allahu të mëshirofte!” etj.

Këto shprehje përdoren kur dikush e përkujton Allahun, i lutet Atij, apo e madhëron.

Për shembull, “Allahu të ruajtë!” shpreh faktin se Allahu ka fuqi të paskajshme mbi ty dhe mbi çdo qenie të gjallë apo jo të gjallë përreth teje. Allahu është Ai, i Cili mund t'ju shpëtojë ju, nënën tuaj, babain si dhe shokët tuaj nga e keqja. Për këtë arsye, kjo thënie përdoret shpesh kur përmendet ndonjë fatkeqësi natyrore apo ndonjë ndodhi tjetër e

papëlqyer. Mendoni vetëm për një çast: A mundet nëna apo babai juaj apo kushdo tjetër që ju njihni ta parandalojë një fatkeqësi natyrore, për shembull, një përmytje? Sigurisht që nuk munden, pasi, është Allahu Ai që i bën që këto gjëra të ndodhin, dhe në të njëjtën mënyrë, vetëm Ai mund t'i parandalojë.

Fjala "Insha'Allah" dmth., "Në dashtë Allahu". Kështu që, kur themi që do të bëjmë apo s'do të bëjmë diçka, është me rëndësi që të themi "Insha'Allah". Kjo për arsye se, vetëm Allahu e di të ardhmen dhe e krijon ashtu si dëshiron Ai. Asgjë nuk ndodh pa dëshirën e Tij.

Kur ndonjëri nga shokët tanë, për shembull, thotë, "Nesër do të shkoj në shkollë patjetër", ai apo ajo bën gabim, pasi, nuk e dimë se çfarë dëshiron Allahu që të bëjë ai apo ajo në të ardhmen. Ndoshta të nesërmen ai apo ajo do të sëmuren dhe nuk do të jenë në gjendje të shkojnë fare në shkollë, apo ndonjë kohë e keqe do të bëjë që të mos zhvillohet mësimi fare.

Për këtë arsye themi "Insha'Allah" kur shprehim synimet tona për të ardhmen dhe kështu, pranojmë se Allahu i di të gjitha, dhe se gjithçka ndodh vetëm në sajë të Vullnetit të Tij dhe kurrë nuk do të mund të dimë më shumë se ato çka na mësuar Allahu. Në këtë mënyrë, ne shfaqim nderimin e duhur ndaj Zotit tonë, i Cili ka fuqi dhe dituri të pamatë.

Në vargjet e Kur'anit, Allahu na mëson si të themi "Insha'Allah" (Në dashtë Allahu):

Dhe mos thuaj kurrësi për ndonjë çështje: "Unë do ta bëj këtë nesër!" Vetëm (nëse i shton): "Në dashtë Allahu!" E kur të harrosh,

përmende Zotin tënd dhe thuaj:

"Shpresohet se Zoti im do të më japë
udhëzim edhe më të afërt prej këtij".

(Kehf: 23-24)

Ndoshta, ju mund të mos dini shumë për këto gjëra, por, kjo nuk ka rëndësi. Që ta njihni Allahun, duhet vetëm që të vështroni përreth dhe të mendoni.

Çdo vend është i mbushur me bukuri dhe na tregon cilësitë e Allahut dhe fuqinë e Tij të paskajshme. Mendoni një lepurush të bardhë e të bukur, fytyrat e qeshura të delfinëve, ngjyrat e mrekullueshme të krahëve të fluturave apo detin e kaltër, pyjet e gjelbra, llojet e ndryshme të luleve si dhe bukuri tjera, të panumërta nëpër botë. Allahu është Ai, i Cili i krijon të gjitha këto. Allahu ka krijuar tërë gjithësinë, botën dhe krijesat në të, nga asgjëja. Prandaj, kur shihni bukuritë që Ai krijon, mund të kuptoni fuqinë e Tij të pakufishme.

Është fakt se, vetë qenia jonë tregon për ekzistencën e Allahut. Pra, le të mendojmë në fillim për qenien tonë dhe si na ka krijuar Allahu në mënyrë kaq të përsosur.





Si u krijua njeriu?

E keni vrarë mendjen ndonjëherë se si është krijuar njeriu? Ndoshta ju mund të thoni: “Çdokush ka nënë dhe baba.” Por kjo përgjigje është e pamjaftueshme. Mbi të gjitha, ajo nuk shpjegon se si u krijua nëna dhe babai i parë, pra njeriu i parë. Ju patjetër duhet të keni dëgjuar disa histori për këtë temë në shkollë apo prej njerëzve përreth. Megjithatë, e vetmja përgjigje e saktë është se, Allahu është Ai, i Cili ju ka krijuar. Mbi këtë temë do të ndalemi më hollësisht në kapitujt e ardhshëm. Tani për tani, një gjë duhet ta dimë të gjithë: njeriu i parë që u shfaq mbi tokë ishte Profeti Adem, paqja qoftë mbi të. Të gjithë njerëzit e tjerë e kanë prejardhjen nga ai.

Ademi, paqja qoftë mbi të, ishte si ne, një njeri që ecte, fliste, falej dhe adhuronte Allahun. Allahu, së pari e krijoi atë, pastaj edhe gruan e tij. Pastaj fëmijët e tyre u shpërndanë nëpër gjithë botën. Kurrë mos harroni se, kur Allahu krijon nuk ka nevojë për gjë tjetër veç një urdhri. Kur Ai dëshiron dëshiron diçka, jep urdhrin: “Bëhu!” dhe ajo bëhet. Ai ka fuqi të mjaftueshme që të bëjë çdo gjë. Për shembull, Ai e krijoi Ademin nga balta. Kjo është shumë e lehtë për Allahun.

Megjithatë, kurrë mos harroni se, ka njerëz që e mohojnë qenien e Allahut. Këta njerëz japin përgjigje të tjera pyetjes si është krijuar njeriu. Ata nuk e kërkojnë të vërtetën.

Nëse një personazh nga një film vizatimor do të thoshte: “Unë u krijova atëherë kur boja u shpërnda në letër rastësisht. Bojërat, po ashtu, u përhapën rëstësisht dhe formuan ngjyrat. Unë nuk kam nevojë



Nëse djali në vizatim do t'ju thoshte: “Piktura ime u vizatua duke përhapur bojën mbi letër krejt rastësisht”, kjo do t'ju tingëllonte shumë e çuditshme, sepse ne e dimë se duhet të ketë patjetër një artist i cili ta vizatojë atë. Po ashtu, edhe një njeri do të na dukej pa mend nëse ai nuk e pranon faktin që Allahu e krijoi atë.

për askënd që të më vizatojë dhe të më japë formë. Mund të lind vetvetiu, rastësisht.” Këtë sigurisht, nuk do ta besonit. Ju e dini se, konturet, ngjyrat dhe lëvizjet e përsosura në filmin vizatimor nuk mund të formohen me hedhjen e ngjyrës andej-këndeje, pa destinacion të caktuar, sepse po të derdhim një shishe boje vetëm rrëmujë mund të bëhet; ajo kurrë nuk mund të formojë vizatim të bukur me forma të rregullta. Që të bëhet diçka me kuptim dhe me qëllim, dikush duhet ta mendojë, ta skicojë dhe ta vizatojë.

Për të kuptuar gjithë këtë, nuk ka nevojë që të shihni artistin dhe piktorin. Ju menjëherë e kuptoni se piktori i ka dhënë personazhit tiparet e tij, formën dhe ngjyrat, dhe aftësi për të folur, ecur apo kërcyer. Pas këtij shembulli, mendoni pak për këtë: Dikush që nuk e pranon se e ka krijuar Allahu, po thotë një gënjeshtër, sikurse personazhi i filmit vizatimor. Supozojmë se një njeri i tillë na flet ne. Të

shohim se si përpiqet ai të na shpjegojë dhe si është krijuar ai dhe gjithë njerëzit e tjerë.

“Unë, nëna ime, babai, prindërit e tyre dhe stërgjyshërit e parë nga lashtësia erdhëm në këtë botë rastësisht. Rastësia na krijoi trupin tonë, sytë, veshët dhe të gjitha organet.” Fjalët e këtij njeriu që mohon se e ka krijuar Allahu, janë shumë të ngjashme me atë personazhin e filmit vizatimor. Ndryshimi i vetëm është se, personazhi është i krijuar nga format dhe ngjyrat në letër. Ai që i shqipton këto fjalë është njeri i përbërë nga qelizat. Por a përbën kjo ndonjë dallim? A nuk është ky njeri, që i thotë këto fjalë, një organizëm shumë kompleks më i përsosur

Piktori ka vizatuar gjithë tiparet e personazheve të filmit vizatimor, format e tyre , ngjyrat, si dhe aftësitë e tyre si: të ecurit, të vrapuarit apo kërcimi.



sesa personazhi i filmit vizatimor? A nuk ka më shumë organe? Me fjalë të tjera, nëse është e pamundur që personazhi i filmit të vizatuar të krijohet rastësisht, atëherë është edhe më shumë e pamundur që ky njeri të krijohet rastësisht. Tani, le t'i bëjmë një pyetje këtij njeriu:

“Ti ke një trup të mrekullueshëm që funksionon në mënyrë të përsosur. Duart e tua mund të mbajnë objekte me delikatesë të madhe, më mirë sesa makinat më të zhvilluara. Mund të vraposh me këmbët e tua. Ke një shikim të përsosur, më të mprehtë se kamerat e cilësisë më të lartë. Në veshët e tu kurrë nuk ndien ushëtimë. Asnjë aparat “hi-fi” i ndjeshëm nuk mund të prodhojë tingull më të qartë. Shumë organe, për të cilat as nuk je i vetëdijshëm, punojnë së bashku për të të mbajtur gjallë. Për shembull, edhe pse nuk ke kontroll mbi punën e zemrës, veshkave apo mëlçisë, ato punojnë vazhdimisht në mënyrë të përkryer. Sot, me qindra shkencëtarë dhe inxhinierë punojnë zellshëm në mënyrë që të prodhojnë makina të ngjashme me këto organe. Sidoqoftë, përpjekjet e tyre janë të kota. Me fjalë të tjera, ti je një krijesë e përsosur, shembulli i së cilës nuk mund të fabrikohet nga njeriu. Si e shpjegon ti gjithë këtë?”

Njeriu i cili e mohon se i ka krijuar Allahu të gjitha gjërat, sigurisht, që do të thoshte: -“Unë di gjithashtu se kemi trup të përkryer dhe organe të përsosura. Por, unë besoj në faktin se: atomet e pajeta dhe të pavetëdijshme bashkohen dhe formojnë organet dhe trupin tonë.”

Pa dyshim, do të vëresh se, këto fjalë janë të paarsyeshme dhe të çuditshme. Pa marrë parasysh moshën dhe profesionin, ai që i shpreh

këto pohime sigurisht nuk mendon në mënyrë të arsyeshme dhe ka ide të gabuara. Për çudi, ne shpesh hasim njerëz që besojnë ende në gjëra të tilla joracionale. Edhe makina më e thjeshtë e ka projektuesin e vet, atëherë sistemi kompleks i njeriut nuk mund të ketë lindur rastësisht. Nuk ka dyshim se Allahu e krijoi njeriun e parë. Allahu, gjithashtu, ka krijuar sistemet e brendshme të njeriut në mënyrë që të shumohet dhe të vijnë brezat e ardhshëm. Allahu siguroi njerëzimin se do të jetojë me ndihmën e një programi të vendosur në qelizë. Ne, gjithashtu, formësohemi falë këtij programi të krijuar nga Allahu, dhe vazhdojmë të rritemi sipas këtij programi. Nga ato që do të lexoni për këtë temë,

Edhe organet artificiale të robotit të ndërtuar me një teknologji të lartë mbeten mjaft të ngurta dhe primitive krahasuar me organet e trupit të njeriut. Allahu e krijoi njeriun në formë të përsosur dhe çdo detaj në trupin tonë e manifeston këtë përsosmëri.





Sytë tanë shohin më mirë se sa kamera më e ndjeshme, veshët tanë mund të dëgjojnë më qartë se mikrofoni më i mirë dhe sistemi stereofonik më i fundit. Nuk ka asnjë dyshim se, cilësitë e shkëlqyera të trupit tonë nuk kanë ardhur në jetë spontanisht. Ashtu si me të gjithë sistemet e përsosura në trupin tonë, është Zoti ynë Ai që i krijoi ato.



në faqet në vazhdim do të keni mundësi që të kuptoni më mirë se Allahu, Krijuesi ynë, ka fuqi dhe mençuri të pamatë.

Program i Përsosur në Trupin e Njeriut

Në faqen e kaluar, përmendëm një program të përsosur që Allahu e ka vendosur në trupin e njeriut. Falë këtij programi, çdo njeri ka sy, veshë, duar dhe këmbë. Përsëri, falë këtij programi, të gjithë njerëzit duken mjaft të ngjashëm megjithë disa ndryshimeve në pamjen e tyre. Ne u ngajmë të afërme tanë, por kemi edhe tiparet tona dalluese për shkak të këtij programi. Për shembull, kinezët dhe japonezët, në përgjithësi, ngajnë njeri me tjetrin, gjithashtu edhe afrikanët kanë ngjyrën e vet tipike të lëkurës, karakteristikat e fytyrës, si dhe tiparet e veçanta të gojës dhe syve.


Tani të shpjegojmë se, si është ky program me shembullin e mëposhtëm:

Ju duhet të dini diçka rreth punës së kompjuterave. Kompjuteri projektohet nga eksperti. Ekspertët në fabrikat speciale, me ndihmën e teknologjive të përparuara, gjithashtu, prodhojnë pjesë përbërëse plotësuese, si: mikroprocesorin, monitorin, tastierën, CD-në, altoparlantët, etj. Ja tek keni gati "trurin" që është i aftë që të përpunojë operatione shumë komplekse. Mund të luash lojëra apo të shkruash çfarë të duash. Por, që të bëhet e tërë kjo, nevojiten programe. Pa këto programe, që përgatiten nga ekspertët, kompjuteri nuk është në gjendje të punojë.



Megjithë dallimet sipërfaqësore midis racave, të gjithë kanë tipare të njëjta kryesore dhe të pandryshueshme si: goja, hunda, sytë dhe veshët. Për shkak të programimeve të ndryshme që Allahu ka vendosur në trupin tonë, ne të gjithë kemi karakteristika kryesore të njëjta, ndonëse mund të dukemi në pamje të parë të ndryshëm.

TË MËSOJMË ISLAMIN TONË



Përveç kësaj, ne e dimë se, jo çdo program përshtatet me çdo lloj kompjuteri, kjo dmth, se programuesi duhet do t'i njohë edhe kompjuterin edhe programin që i përshtatet. Siç e kemi parë, për të vënë në punë një kompjuter na nevojitet një njësi qendrore dhe një program i përshtatshëm. Por, më me rëndësi është fakti se, nëse askush nuk do t'i projektonte apo prodhonte këto gjëra, përsëri, kompjuteri nuk do të mund të punonte. Edhe trupi i njeriut është i ngjashëm me kompjuterin. Siç thamë edhe më lart, ekziston një program në qelizat tona, që bën të mundur jetën tonë. Shtrohet pyetja, si ndodhi që u projektua ky program? Përgjigja është e qartë:

Me qëllim që të punojë një kompjuter duhet programi. Po ashtu, edhe një njeri jeton falë një informacioni të ngjashëm me programin e kompjuterit, të cilin Allahu e ka vendosur në gjenet tona.



Trupi ynë ka një sistem shumë më të ndërlikuar se sa një kompjuter. Por, asnjëri nuk pretendon se një kompjuter është ndërtuar rastësisht, megjithatë disa njerëz pretendojnë se trupi ynë i kanë fituar këto cilësi rastësisht.



Allahu i Plotfuqishëm, krijon çdo njeri në mënyrë të papërsëritshme. Allahu është Ai që ka krijuar trupin tonë si dhe programin që i jep formë atij. Por, mos më keqkuptoni. Nga një pikëpamje tjetër, është e pamundur që të krahasohet trupi i njeriut me një kompjuter. Trupi ynë është pafundësisht më madhështor sesa kompjuteri më i përparuar. Vetëm trupi ynë, për shembull, është shumë më i ndërlikuar sesa një kompjuter. Tani të shohim se si lind një foshnjë: në fillim, ekziston vetëm një copëz mishi në barkun e nënës. Gjatë kalimit të kohës, kjo copëz mishi rritet dhe merr formë.





Gjatësia jote, ngjyra e syve të tu, vetullat tuaja, forma e duarve të tua dhe qindra karakteristika të tjera, të gjitha janë paracaktuar qysh nga momentet e para të fillimit të krijimit tuaj. Gjithë ky informacion paketohet në atë program fillestar që Allahu e ka vendosur në qelizat tuaja. Ky program është aq i përkryer dhe i ndërlikuar sa që shkencëtarët, vetëm kohëve të fundit, pak e kanë kuptuar se si funksionon.

Ngjyra e syve tanë apo gjatësia që do të kemi kur të rritemi mund të njihen qysh në mitrën e nënës. Kockat, muskujt, koka, sytë dhe veshët fillojnë të krijohen pikërisht në vendin dhe në rendin e duhur. Asnjë nga organet tona nuk bën asnjë gabim dhe asnjëri nuk ia ze vendin tjetrit.



Ne rritemi gradualisht në përputhje me programin që Allahu ka vendosur në trupin tonë. Pamja e një foshnje të porsalindur, që shndërrohet befasisht në një plak para syve tanë, do të ishte shumë tronditëse.

Ne rritemi gradualisht në pajtim me programin që Allahu e ka vendosur në trupin tonë. Për këtë arsye, rritja e trupit tonë nuk na duket diçka e çuditshme, por e natyrshme. Duhet vite të tëra që të rritemi. Do të na

dukej çudi nëse ky program do të punonte më shpejt. Pamja e një foshnje të porsalindur që të shndërrohej befasisht në një plak, para syve tanë, do të ishte shumë habitëse.



Si u krijuan qeniet e tjera të gjalla?

Njerëzit nuk janë të vetmet krijesa që jetojnë mbi tokë. Mbi të ka edhe mijëra qenie të tjera të gjalla, disa prej të cilave ju mund t'i njihni e disa jo. Disa nga ato gjenden përreth jush dhe mund t'i shihni kudo. Disa prej tyre, janë aq larg sa mund t'i shihni vetëm nëpër libra apo në emisione televizive. Por, nëse do t'i vështronit me vëmendje do të vinit

re se, të gjitha kanë një veti të përbashkët. Mund ta gjeni se për cilën veti është fjala? Ne mund ta quajmë këtë veti "përshtatje." Tani le t'i numërojmë se me çfarë përshtaten krijesat e gjalla? Ato janë në përshtatje me:

- o Ambientin në të cilin jetojnë,
- o Gjallesat e tjera me të cilat bashkëjetojnë,
- o Elementet që mbajnë baraspeshën në natyrë,
- o Faktorët që sigurojnë dobi për njerëzit.

Para se të thellohemi në këtë temë, të marrim një shembull në mënyrë që të shpjegojmë domethënien e fjalës "përshtatje". Mendoni prizat dhe spinat në shtëpinë tuaj. Ato i përshtaten shumë mirë njëra-tjetrës. Si mund ta shpjgoni se ato përshtaten me njëra-tjetrën? Kjo ndodh sepse në prizë ka vrima ku hyjnë majat e spinës. Ua merr mendja se ky shpjegim është i mjaftueshëm? Gjerësia e majave të spinës është e barabartë me gjerësinë e vrimave të prizës. Nëse nuk do të ishte ashtu, spina kurrë nuk do të hynte në prizë. Largësia në mes të majave të spinës dhe largësia mes vrimave të prizës janë gjithashtu të njëjta. Nëse nuk do të ishin po ashtu të njëjta, spina kurrë nuk do të hynte në prizë.

Sidoqoftë, vetëm këto veti nuk janë të mjaftueshme që të kemi përshtatje mes prizës dhe spinës. Nëse spina do të ishte shumë e gjatë,





Allahu e ka krijuar çdo gjallesë në një ambient në të cilin ajo mund të mbijetojë. Kështu, peshqit mund të marrin frymë nën ujë, zogjtë mund të fluturojnë në qiell dhe gjitarët mund të jetojnë mbi tokë.

përsëri nuk do të kishte përshtatje. Nëse majat e spinës nuk do të ishin metalike, ato nuk do të mund ta përçonin rrymën elektrike. Nëse spina nuk do të ishte e mbështjellë me material plastik, atëherë rryma do të na godiste. Siç mund të shihet, mungesa e përshtatjes, madje edhe në një aparat shumë të thjeshtë e bën aparatin apo mjetin të papërdorshëm. Kjo do të thotë se, i njëjti person e ka ndërtuar edhe prizën edhe spinën dhe ai i ka projektuar që të jenë në përshtatje me njëra tjetrën. Po ashtu, i ka bërë ato të përdorshme. Është fort e pabesueshme që metali dhe plastika të bashkohen vetë rastësisht dhe të jenë punuar ndarazi dhe të pavarura prej njëra-tjetrës, pasi në një rast të tillë, kurrë nuk do të mund të gjenit një prizë dhe një spinë që janë në përshtatje me njëra-tjetrën.

Përshtatja mes qenieve të gjalla është madje edhe më e ndërlikuar sesa përshtatja mes prizës dhe spinës, pasi, qeniet e gjalla përmbajnë me mijëra sisteme dhe organe që duhet të bashkëjetojnë në harmoni dhe të punojnë së bashku në mënyrë të përsosur. Çdo përpjekje për të përshkruar këto sisteme një nga një do të mbushte një bibliotekë prej qindra librash. Prandaj, në faqet në vazhdim, do të ndalemi në këto veti të përsosura të qenieve të gjalla, që i ka krijuar Allahu:

Qeniet e gjalla janë krijuar në përshtatje me ambientin në të cilin jetojnë

Çdo qenie e gjallë, mbi tokë apo në ajër, përshtatet në mënyrë të përsosur me vendbanimin e saj sepse në këtë mënyrë janë krijuar.

Bletët mbartin polenin e luleve dhe e çojnë atë nga një lule në tjetrën. Ky është procesi që bën të mundur riprodhimin e luleve. Ngjashëm, peshqit pastrues pastrojnë peshqit e tjerë.



Në krijimin e qenieve të gjalla në natyrë ka ekuilibër. Në sajë të këtij ekuilibri të përsosur, ato mund të mbijetojnë si lloje me miliona vjet.



Sisteme të ndryshme të përsosura sigurojnë ushqimin, mbrojtjen dhe shumimin e qenieve të gjalla.

Kjo do të thotë se, çdo qenie e gjallë është projektuar në mënyrë të veçantë, në përshtatje me ambientin ku jeton.

Organet dhe mënyra e jetës së qenieve të gjalla janë të gjitha në përshtatje me kushtet në ambientin e tyre. Për shembull, zogjtë kanë krahë të përsosur për të fluturuar në qiell. Peshqit kanë velëza të posaçme, me të cilat marrin frymë në ujë. Nëse do të kishin mushkëri si tonat, ata do të mbyteshin në ujë.

Qeniet e gjalla janë krijuar në përshtatje me qeniet e tjera të gjalla me të cilat bashkëjetojnë

Disa zogj dhe insekte ndihmojnë në shumimin e bimëve. Kjo do të thotë se, edhe pse janë të pavetëdijshëm për këtë, ata ndihmojnë në rritjen e bimëve. Për shembull, kur bleta shkon nga një lule në tjetrën, merr me vete edhe polenin. Falë këtij procesi, bimët mund të shumohen. Në disa raste, kafshët kryejnë veprime që janë të dobishme për kafshët e tjera.

Peshku pastrues, për shembull, pastron mikroorganizmat nga lëkura e peshqve të mëdhenj dhe, në këtë mënyrë, siguron themelin e një jete më të shëndetshme për ta. Kjo është një formë tjetër e përshtatjes.



Qeniet e gjalla janë krijuar në përshtatje me elementët që sigurojnë baraspeshën në natyrë

Asnjë qenie e gjallë, përveç njeriut, nuk e çrregullon baraspeshën në natyrë. Për më tepër, ato janë krijuar të pajisura me veti të tilla që ta ruajnë këtë baraspeshë. Sidoqoftë, baraspesha në tokë gjithmonë është e ndjeshme nga sjellja e paditur e njeriut. Për shembull, nëse njeriu gjuan ndonjë lloj përtej kufirit të arsyeshëm, ai lloj do të zhduket. Zhdukja e atij lloji shkakton rritje të madhe në numër të presë së tij, çka me kohë do të verë në rrezik jetën e njerëzve e madje edhe të vetë

Ne kemi nevojë çdo ditë për ushqime si: mishin, qumështin, vezët, mishin e pulës, mjaltin, perimet dhe frutat. Edhe shumë burime të tjera ushqimi janë mirësi të cilat Allahu i krijoi për ne, në mënyrë që ne ta falenderojmë.



natyrës. Prandaj, ekziston një barazpeshim i lindur në krijimin e qenieve të gjalla; ato janë tërësisht në përshtatje me baraspeshën e natyrës, por, vetëm njeriu ka mundësi që ta shkatërrojë këtë baraspeshë të ndjeshme.

Qeniet e gjalla janë në përshtatje me faktorët që u sjellin dobi njerëzve

Për shembull, mendo se sa i mirë është mjalti për ty. Ku e dinë bletët që ty të nevojitet ky lloj ushqimi dhe si e prodhojnë ato mjaltin? A mundet pula, lopa apo delja që të njohin nevojat ushqimore të njerëzve dhe të prodhojnë lëndë ushqyese për t'i plotësuar këto nevoja? Natyrisht që jo.

Kjo harmoni e pabesueshme mes qenieve të gjalla është një provë shumë e qartë që tregon se i ka krijuar një Krijues i vetëm. Kjo baraspeshë ekziston në tokë falë krijimit të përsosur të Allahut.

Krijimi i Universit

Deri tani, kemi shpjeguar krijimin e qenieve të gjalla nga Allahu. Tani, erdhi rradha të shqyrtojmë universin në tërësi. Allahu krijoi gjithësinë në të cilën ekzistoni ju, toka, dielli, sistemi diellor, planetet, yjet, galaktikat dhe çdo gjë tjetër.

Sidoqoftë, ashtu si ata njerëz që kundërshtojnë faktin e krijimit të qenieve të gjalla, ka edhe njerëz të tillë që mohojnë faktin se gjithësia është krijuar. Këta njerëz pohojnë se universi është krijuar spontanisht. Përveç kësaj, ata sugjerojnë se universi ka ekzistuar gjithmonë.




Çdo njeri pajtohet me mendimin se qyteti modern dhe mjaft i zhvilluar në këtë pikturë nuk mund të jetë krijuar rastësisht dhe se ai është projektuar dhe ndërtuar nga arkitektë ekspertë, inxhinierë dhe muratorë. Asnjë njeri nuk do të mendonte ndryshe.

Sidoqoftë, ata kurrë nuk kanë sjellë ndonjë shpjegim për këtë pohim të pabazë. Pohimi i tyre është i ngjashëm me këtë shembull: imagjino sikur të nisje të lundroje në det dhe një ditë të arrije në breg të një ishulli. Çfarë do të mendoje nëse do të gjeje një qytet shumë të zhvilluar, me rrokaqiej, të rrethuar me parqe dhe gjelbërim? Përveç kësaj, ky qytet të ishte plot me restorante, teatro dhe linja hekurudhore. Sigurisht që, do të mendoje se ky qytet është projektuar dhe ndërtuar nga njerëz inteligjentë, apo jo? Çfarë do të mendoje nëse dikush do të thoshte: "Askush nuk e ka ndërtuar këtë qytet. Ai gjithmonë ka



Universi në të cilin jetojmë është pakrahasueshmërisht më i madh se qyteti që pamë në faqen e kaluar. Ai po ashtu ka ndërtim më të madhështor se ai qytet.



*Ai është Krijuesi i qiejve
dhe i tokës! Prej nga të këtë
fëmijë kur nuk ka bashkëshorte?!
Ai krijon çdo send, dhe
Ai di çdo send.
(Sure 6 En'am: 101)*

Në këtë rast, a mund të themi se një univers i përsosur nuk është krijuar, por erdhi në jetë rastësisht? Një pohim i tillë pa dyshim që do të tingëllonte shumë i pakuptimtë. Është Zoti ynë, i Cili e krijoi rendin e përkryer në ndërtimin e university.

ekzistuar, dhe kemi ardhur dikur, në të kaluarën, dhe banojmë në të. Këtu kemi të gjitha gjërat e domosdoshme dhe të gjitha janë krijuar spontanisht?”

Padyshim që, do të mendoje se ai është ndonjë i çmendur, apo do të mendoje se ai nuk di se çfarë po flet. Por, kurrë mos harro se universi, në të cilin jetojmë, është pakrahasueshmërisht më i madh se ai qytet. Universi përmban një numër thuajse të pakufishëm të planeteve, yjeve, kometave dhe satelitëve të llojeve të ndryshëm. Duke qënë kështu, pohimet e një njeriu që thotë se, kjo përsosmëri e universit nuk është e krijuar, por, ka ekzistuar përgjithmonë, nuk duhet të mbetet pa përgjigje. A nuk pajtoheni?

Pasi të lexoni atë që vijon më poshtë, ju vetë mund ta gjeni përgjigjen më të mirë. Le të thellohemi tani në temën e universit dhe ta ruajmë përgjigjen për në fund.

Çdo Gjë Ka Filluar të Formohet Pas Një Shpërthimi të Madh

Gjatë kohës kur njerëzit nuk kishin teleskopë që të bënin vrojtime në qiell, ata kishin shumë pak dije, edhe ato të dyshimta, për gjithësinë e largët, dhe kishin mendime të ndryshme për hapësirën kozmike. Me zhvillimin e teknologjisë, ata arritën të përftojnë dije të sakta për hapësirën. Nga mesi i shek. të 20-të, ata zbuluan diçka shumë të rëndësishme. Gjithësia paska ditëlindje, që do të thotë se, universi nuk ka ekzistuar gjithmonë. Universi, me fjalë të tjera, yjet, planetet dhe galaktikat kanë filluar të formohen në një datë të caktuar.

Shkencëtarët kanë llogaritur vjetërsinë e universit të jetë 15

miliardë vjet. Ata e quajtën momentin kur lindi gjithësia me emrin “Big Beng”, pasi, para 15 miliardë vjetëve, kur nuk ekzistonte asgjë, çdo gjë u krijua pas një shpërthimi nga një pikë e vetme. Shkurtimisht, materia dhe gjithësia, që njerëzit supozonin se kanë ekzistuar përgjithmonë, paskan një fillim. Tani, shtrohet pyetja, “Si arritën ata të kuptojnë se, gjithësia kishte një fillim?” Kjo ishte shumë e lehtë; materia që u largua dhe u shpërnda prej pjesëve të tjera të materies nga shpërthimi i madh ende është duke lëvizur. Mendo vetëm një çast! Universi vazhdon të zgjerohet edhe këtë çast. Imagjino universin si një tullumbace. Nëse vizatojmë dy pika të vogla në të, çfarë do të ndodhë nëse e fryjmë? Pikat në tullumbace do të largohen nga njëra tjetra gjatë rritjes së vëllimit të saj. Sikurse në rastin e tullumbaces, vëllimi i universit gjithashtu rritet, dhe çdo gjë brenda largohet nga tjetra. Me fjalë të tjera, largësia mes yjeve, galaktikave dhe meteorëve është duke u rritur vazhdimisht.



Ashtu si pikëzat e vogla të vizatuara mbi tullumbace do të largoheshin nga njëra-tjetra kur e fryjmë, edhe trupat qiellorë largohen nga njëri-tjetri si pasojë e Big Bengut, apo Shpërthimit të Madh.

TË MËSOJMË ISLAMIN TONË

Imagjinoni se jeni duke e ndjekur zgjerimin e universit në një film vizatimor. Si do të të dukej universi nëse e kthejmë filmin prapa nga fillimi? Do të zvogëlohej deri tek një pikë e vetme, apo jo? Kjo është ajo që kanë bërë shkenctarët. Ata u kthyen në fillim të Big Bengut dhe e kuptuan se universi përherë-zgjerues, në fillim, ka qenë vetëm një pikë e vetme.

Ky shpërthim, i quajtur Big Beng, u bë pika fillestare e ekzistencës që Allahu kishte paracaktuar për universin. Me këtë shpërthim, Allahu krijoi grimcat që përbëjnë universin, dhe në këtë mënyrë u shfaq materia. Ajo u shpërnda me një shpejtësi të paimagjinueshme. Gjatë çasteve fillestare të shpërthimit, ky ambient i ngjante një supe prej materie, e përbërë nga grimca të ndryshme. Por, me kalimin e kohës, ky kaos i madh filloi të transformohej në një strukturë të rregullt. Allahu krijoi atomet nga grimcat, dhe përfundimisht, yjet nga atomet. Allahu krijoi tërë gjithësinë dhe gjithçka ka në të.

Po ta imagjinonit zgjerimin e universit si një film, duke i shpalosur imazhet që nga fillimi, do të shihnit se, në fillim, ai nuk ishte gjë tjetër veçse një pikë e vetme.



Le të japim një shembull në mënyrë që ta sqarojmë gjithë këtë:

Mendo një hapësirë shumë të madhe. Është tërësisht e pakufizuar. Aty ndodhet një enë e mbushur përplot me ngjyra. Asgjë tjetër nuk ekziston. Në këtë enë, janë të përziera të gjitha ngjyrat, duke formuar ngjyra të pazakonta. Imagjino një bombë që shpërthen në këtë enë, si pasojë e së cilës ngjyrat shpërndahen gjithkrah në formën e pikëzave. Imagjino sikur me miliona pikëza boje lëvizin në të gjitha drejtimet në këtë hapësirë. Ndërkohë, gjatë këtij udhëtimi të pikëzave, fillojnë të ndodhin gjëra të pazakonshme. Në vend që të formohet një rrëmujë kaotike dhe të zhdukej përfundimisht, ato filluan që të bashkëveprojnë sikur të ishin qenie inteligjente. Pikëzat, të cilat në fillim, formuan një përzjerje të ngjyrosur, filluan që të përzgjidhen në ngjyra të veçanta. E kaltra, e verdha, e kuqja dhe të gjitha pikëzat me ngjyrë të njëjtë u



Bojërat në enë shpërndahen përreth si pasojë e shpërthimit. A mund të ndodhë që, pikat e bojës të shpërndara rastësisht rreth e rrotull të bashkohen dhe të formojnë pikturën që shihni në hapësirën kozmike? Formimi i rastësishëm i kësaj pikturë është përfundimisht i pamundshëm. Mbrojtja e teorisë se universi u krijua rastësisht është më e palogjikshme se sa formimi i i rastësishëm i pikturës.

grumbulluan së bashku dhe vazhduan lëvizjen. Madje, filluan të ndodhin disa gjëra edhe më të pazakonshme: 500 pikëza të kaltra u bashkuan dhe vazhdojnë udhëtimin e tyre në formën e një pike të madhe. Ndërkohë, 300 pikëza të kuqe në një skaj dhe 200 pikëza të verdha bashkohen dhe vazhdojnë shpërndarjen e tyre të bashkuara. Këto grupe të ndara ngjyrash largohen nga njëra-tjetra dhe formojnë pamje të bukura, sikur të veprojnë sipas urdhërave të dikujt.

Disa pikëza u bashkuan dhe formuan imazhin e yjeve, të tjerat diellin, ndërsa, disa të tjera formuan planetet rreth këtij dielli. Një grup tjetër pikash formuan pikturën e tokës, ndërsa disa të tjera formuan hënën. Por, a mund të ndodhnin gjithë këto gjëra vetvetiu?

Askujt nuk ia merr mendja që kjo të jetë e mundur.

Siç tregon rasti me pikat e ngjyrës, materia u bashkua dhe formoi një pikturë të përsosur, që ne e shohim kur e ngremë kokën dhe shikojmë qiellin, me fjalë të tjera, yjet, diellin dhe planetet. Por, a mund të ndodhin vetvetiu gjithë këto gjëra?

Si mund të krijohen qielli, planetet, dielli, hëna dhe toka si rezultat i bashkimit të rastësishëm të atomeve pas një shpërthimi? Po nëna juaj, babai, shokët apo zogjtë, macet, bananet apo luleshtrydhet..? Natyrisht, kjo është e pamundur që të ketë ndodhur. Një ide e tillë është aq absurde sikur të pohojmë se një shtëpi nuk është e ndërtuar nga punëtorët, por është krijuar në sajë të vullnetit të lirë të tullave dhe tjegullave, dhe krejtësisht rastësisht. Të gjithë e dimë se tullat e shpërndara përreth nga një shpërthim bombe nuk mund të formojnë shtëpiza. Ato shpërbëhen në gurë dhe dhé, dhe me kohë shndërrohen në tokë.

Por, një çështje meriton vëmendje të veçantë. Siç e dini, pikat e ngjyrës janë të pavetëdijshme dhe materie jo e gjallë. Është e pamundur që pikat e ngjyrës mund të bashkohen spontanisht dhe të formojnë piktura. Këtu, ne jemi duke biseduar për formimin e qenieve të gjalla dhe të vetëdijshme. Është sigurisht shumë e pamundur që qeniet e gjalla si njerëzit, bimët dhe kafshët mund të krijohen nga materia jo e gjallë përmes rastit të hamendësuar. Që të kuptohet më lehtë kjo, duhet që të njohim trupin tonë: ai është i përbërë nga molekulat e vogla dhe të padukshme për syrin tonë, siç janë proteinat, yndyrnat dhe uji... Këto formojnë qelizën, e qelizat formojnë trupin tonë. Rregulli i përsosur në trupin tonë është si prodhim i një projektimi të veçantë. Allahu krijoi sytë tanë që shohin, duart që mbajnë këtë libër dhe këmbët tona që na bëjnë të lëvizim.

Allahu paracaktoi se, si do të zhvillohemi në barkun e nënës, sa të gjatë do të jemi dhe cila do të jetë ngjyra e syve tanë.

Allahu Është Ai, I Cili Krijoi Çdo Gjë

Nëse ju kujtohet, në fillim të këtij libri pamë përgjigjen e saktë që duhet t'i japim një njeriu pabesimtar. Tani ju e keni gati përgjigjen.

Shpërthimet nuk formojnë pikturë të stolitur, por vetëm sa e shkatërrojnë atë. Rregulli që shfaqet pas shpërthimit të universit është edhe më i përsosur sesa shembujt që përmendëm - një qytet apo një enë e mbushur me ngjyrë. Të gjitha këto nuk mund të jenë produkt i rastësisë.

Sistemi i përsosur mund të jetë krijuar vetëm me vullnetin e Allahut të Plotfuqishëm. Allahu është i aftë që të krijojë çdo gjë. Ai vetëm thotë, "Bëhu!" dhe ajo bëhet. Allahu krijoi një botë të bukur në një gjithësi të përsosur për ne, dhe Ai krijoi kafshët dhe bimët në të. Ai krijoi diellin që të prodhojë energji dhe të na ngrohë. Largësia e tokës nga dielli është përshtatur aq mirë me jetën tonë, saqë, nëse dielli do të ishte pak më afër tokës do të ishte shumë nxehtë, por nëse të ishte pak më larg, atëherë të gjithë do të ngrinim.

Sa më shumë fakte zbulojnë shkencëtarët, aq më mirë arrijmë të njohim fuqinë e Allahut. Kjo, për shkak se materia as nuk mund të marrë vendime e as t'i kryejë ato. Kjo do të thotë se, ekziston një Krijues, i Cili e projektton dhe e krijon këtë gjithësi. Materia, lënda që përbën yjet, njerëzit, kafshë, bimët dhe gjithçka tjetër të gjallë ose të jogjallë, gjendet nën kontrollin e Allahut. Kjo është arsyeja pse, çdo gjë në tokë ka rregull; sepse çdo gjë është krijuar nga Allahu, Krijuesi dhe Formëdhënësi.

Allahu Krijoi Çdo Njeri Me Një Fat Të Caktuar

Në fillim të librit, iu treguam se si Allahu krijoi Ademin, paqja qoftë mbi të. Të gjithë njerëzit janë pasardhës të tij. Allahu u ka dhuruar njerëzve jetë në këtë botë në mënyrë që t'i sprovtojë ata dhe ka dërguar atyre profetë që t'ua bëjnë të ditur përgjegjësitë e tyre.



Çdo njeri në këtë botë vihet në sprovë me ngjarjet që përjeton. Me fjalë të tjera, ne jemi vënë në sprovë me sjelljen tonë ndaj ndodhjeve që hasim, me mënyrën se si

flasim dhe me qëndrueshmërinë tonë në përballimin e vështirësive: shkurtimisht, se a sillemi drejt.

Kjo sprovë do të shërbejë që të përcaktohet vendi ynë në jetën e përtejme. Por, prova në këtë botë ka një fshehtësi të rëndësishme. Si një mëshirë dhe

ngushëllim i madh për njerëzimit, Allahu ka krijuar edhe fatin. Fati, domethënë, të gjitha ngjarjet që përjetohe përgjatë jetës, është i paracaktuar nga Allahu, madje, para se të lindim. Për çdo njeri, Allahu ka krijuar fatin e tij apo të saj. Që ta kuptojmë më mirë këtë, ne mund ta

Çdo gjë që përjeton njeriu që nga lindja e deri në vdekje përcaktohet nga fati i tij. Këtë mund ta imagjinoni si një shirit filmi. Nëse do të marrim në dorë një shirit filmi dhe do ta vështrojmë me vëmendje, do të vemë re në të njëjtën kohë, fillimin, mesin dhe fundin e ngjarjeve.



krahasojmë me xhirimin e një videokasete. Si fillimi, ashtu edhe fundi i këtij filmi dihen, por, ne e mësojmë këtë vetëm pasi përfundon filmi. Kështu ndodh edhe me fatin. Çdo gjë që do të kalojë një njeri në jetën e tij, të gjitha përjetimet e tij, shkollat që do të ndjekë, shtëpia ku do të jetojë si dhe momenti i vdekjes së tij, të gjitha këto janë të paracaktuara.

Të gjitha ngjarjet që i ndodhin dikujt, qoftë të mira apo të këqija, janë të paracaktuara në dijen e Allahut. Çdo njeri sprovohet sipas skenarit të vet të shkruar enkas për të. Përmbledhtas mund të themi se, në pajtim me këtë skenar, njeriu kalon nëpër një seri ngjarjesh, dhe besimi i tij, dhe pastaj edhe veprat e tij, po ashtu edhe qëndrimet e tij ndaj këtyre ngjarjeve, përcaktojnë fatin e tij në jetën e përtejme.





Njohuria mbi fatin është një burim i madh ngushëllimi tek njeriu. Ajo është një bekim nga Allahu. Për këtë arsye, nuk ka nevojë njeriu që të ndiejë keqardhje për ndodhitë përfundimi i të cilave është paracaktuar apo të brengoset për ngjarjet që nuk shkojnë mirë. Për ata që shfaqin durim gjatë përvojave të hidhura, duke qenë të vetëdijshëm se të gjitha ndodhin me vullnetin e Allahut, Ai u jep sishariq Xhennetin (Parajsën). Profetët e Allahut kanë qenë shembujt më të mirë në këtë drejtim. Allahu jep njerëzve të tillë përgëzime për Xhennetin për të shpërblyer besimin shembullor dhe sjelljen e tyre të drejtë.



ALLAHU DËRGOI PROFETËT DHE LIBRAT

Në kapitujt e mëparshëm, dhamë shembuj dhe dëshmi që na ndihmojnë të thellohemi dhe të marrim me mend fuqinë dhe madhësitinë e Allahut. Arsyeja pse Allahu na ka dhuruar aftësinë e të menduarit dhe arsyes është që të arrijmë ta njohim Atë. Allahu na ka dërguar edhe Librat e shpallur, përmes të cilëve Ai e prezanton Vetën. Në këto libra Ai shpall atë çfarë pret nga ne. Allahu porositi dhe dërgoi profetët që u bënë shembull për popujt e vet me sjelljen e tyre shembullore. Nëpërmjet profetëve, porosia e qartë dhe shpallja e Allahut shërben si udhërrëfyes për njerëzimin. Është vështirë të dihet saktësisht se, sa profetë ka dërguar Allahu, edhe pse ka gojëdhëna që tregojnë se, përgjatë historisë, kanë qenë 113 të dërguar si dhe një numër shumë më i madh i profetëve. Ne njohim

vetëm emrat e profetëve të përmendur në Kur'an, i cili është shpallja e fundit e dërguar nga Allahu. Allahu na njeh me jetën e profetëve në mënyrë që të na bëjë të mundur të kuptojmë sjelljen e tyre. Përmes të dërguarve, Zoti Ynë na tregon mënyrën e drejtë të jetesës si dhe si të sillemi siç duhet në këtë botë. Vetëm përmes shpalljeve të Allahut mund të mësojmë se si të sillemi, dhe cilat sjellje janë më të mira dhe në pajtim me vlerat e Kur'anit. Vetëm nëpërmjet fjalës së Allahut mund të mësojmë për sjelljet që fitojnë kënaqësinë dhe shpërblimin e Tij të pafund si dhe ato sjellje që të shtyjnë në dënim.

Në Kur'an, Allahu na informon se, përgjatë historisë, Ai dërgoi shumë profetë në të gjithë popujt, në mënyrë që t'u tërheqin vërejtjen. Këta të dërguar i ftuan popujt e tyre që të adhuronin Allahun, t'i luteshin Atij dhe t'u bindeshin urdhërave të Tij. Ai, gjithashtu, ua bëri të qartë atyre se, nëse do të vepronin ndryshe do të dënoheshin. Shkurtimisht, ata ua tërhoqën vërejtjen jobesimtarëve dhe atyre që bënin vepra të këqija, dhe gjithashtu i përgëzonin besimtarët për



Libri i vetëm
i zbritur nga
Allahu, që
ka mbetur i
ruajtur
plotësisht,
është
Kur'ani.

shpërblimin që do të marrin. (Kopshti dhe Zjarri do të shqyrtohen më hollësisht në kapitujt në vijim). Profeti i fundit për njerëzimin ishte Profeti Muhammed, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Kur'ani është Libri i fundit i zbritur.

Shpalljet e mëparshme të Allahut e kanë humbur origjinalitetin e vet, sepse injorantët dhe ata që kishin qëllime të këqija kanë futur fjalët e tyre dhe pjesë shtesë në ta. Në këtë mënyrë, origjinalet, shpalljet e vërteta që fillimisht u ishin dërguar popujve, nuk mbijetuan deri në ditët e sotme. Por, Allahu na dërgoi Kur'anin, Librin që është e pamundur të ndryshohet.

Profeti Muhammed, bekimi i Allahut qoftë mbi të, si dhe muslimanët e tjerë më vonë, e ruajtën Kur'anin shumë mirë. Kur'ani është shumë i qartë për çdokënd dhe kuptohet shumë lehtë. Kur e lexon atë, shpejt kuptohet se është Fjalë e Allahut. Kur'ani, i cili ka mbijetuar i padëmtuar, është nën mbrojtjen e Allahut dhe është Libri i vetëm i shpallur për të cilin njerëzit do të jenë përgjegjës deri në Ditën e Gjykimit.

Sot, të gjithë muslimanët, kudo që ndodhen, lexojnë të njëjtin Kur'an. Asnjë kundërhënie nuk mund të gjendet në ndonjë fjalë apo shkronjë. Kur'ani, i shpallur Profetit tonë, paqja qoftë mbi të, përpiluar nga Kalifi Ebu Bekër dhe më pas shkruar nga Kalifi Uthman, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, të cilët jetuan para 1.400 vjetësh, si dhe Kur'ani që lexojmë sot, janë identikë. Midis tyre ka përputhshmëri fjalë për fjalë. Kjo domethënë që, nga dita kur profetit Muhammed paqja qoftë mbi të, iu shpall Kur'ani, ai ka mbetur i pandryshuar. Kështu,

Allahu e mbrojti Kur'anin nga njerëzit e këqinj, të cilët përpiqeshin ta ndryshonin apo të fusnin pjesë shtesë në të. Në një ajet, Allahu na informon se vetë Ai e ruan Kur'anin:

Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij. (Hixhr: 9)

Me fjalën “Ne” në këtë ajet, Allahu i adresohet Vetes. Nuk ka zot tjetër përpos Allahut, Ai nuk ka shok. Ai është Allahu i Plotfuqishëm, Shpikës i çdo gjëje, i Cili përfshin çdo gjë në dijen e Tij. Në disa pjesë të Kur'anit, Allahu i adresohet Vetes me fjalën “Unë”, ndërsa në disa pjesë me fjalën “Ne”. Në gjuhën arabe, që është edhe gjuhë e Kur'anit, fjala “Ne” ndonjëherë i adresohet edhe një personi me qëllim të ngritjes së ndjenjës së respektit dhe fuqisë tek dëgjuesit. Edhe në gjuhën shqipe, kur dëshirojmë ta respektojmë dikë, i drejtohem me “Ju”. Në kapitujt në vijim të këtij libri, do të japim shembuj nga ajetet (vargjet e Kur'anit) dhe suret (kapitujt e Kur'anit). Ato janë fjalët më të sakta pasi janë fjalët e Allahut, i Cili na njeh neve më mirë se ne vetveten. Në Kur'an, Allahu dëshiron që ne të marrim mësim nga jeta e profetëve. Në një ajet Ai thotë:


Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësimë e përvojë për të zotët e mendjes... (Jusuf: 111)

Allahu në këtë ajet ia tërheq vëmendjen një njeriu që di se Kur'ani është Fjalë e Allahut dhe në këtë mënyrë mendon, e shfrytëzon mendjen e vet dhe përpiqet që ta mësojë Kur'anin dhe të jetojë sipas urdhërave të tij. Allahu i konsideron njerëzit të cilëve u dërgoi profetë, përgjegjës për bindjen e tyre ndaj urdhërave të Tij. Njerëzve të cilëve u ka arritur shpallje nga Allahu, nuk do të kenë arsytim në Ditën e Gjykimit, për



*A nuk e kanë parë ata sa popuj Ne
kemi shfarosur përpara tyre, të cilëve u kemi
mundësuar në Tokë çka nuk ju kemi
mundësuar juve. U kemi dërguar shi të
mjaftueshëm dhe kemi bërë lumenj
që rrjedhin pranë tyre, për shkak të mëkateve
të tyre, i shfarosëm dhe pas tyre
kemi ngritur breznitë tjera.*

(En'Am: 6)



shkak se të dërguarit e Allahut ia transmetuan popullit të tyre njohuritë për qenien e Allahut dhe çfarë sjellje pret Ai nga njerëzit. Kushdo sapo ta dëgjojë këtë mesazh, ai do të jetë përgjegjës për të. Kjo tregohet kështu në Kur'an:

Të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues, në mënyrë që, pas dërgimit të të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para Allahut. All-llahu është i pavarur në sundimin e vet dhe di si të veprojë. (Nisa: 165)

Allahu ka krijuar shumë grupe njerëzish mbi tokë. Disa nga këta grupe refuzuan të dërguarit e tyre që u ishin dërguar dhe i mohuan ata krejtësisht. Për shkak se ata nuk i dëgjuan fjalët e tyre dhe nuk iu bindën urdhërave të Allahut, merituan dënimin. Përmes të dërguarve të Vet, Allahu, gjithashtu, ua tërhoqi vërejtjen këtyre njerëzve të pabindur për një jetë të padurueshme. Përpos kësaj, ata vazhduan të kundërshtojnë të dërguarit e tyre, saqë shpifnin kundër tyre. Madje, ata u bënë aq të ashpër sa, në disa raste edhe i vranë. Për këtë shkak, Allahu i dënoi ata sepse e merituan, dhe me kalimin e kohës, i zëvendësuan popuj të tjerë. Në Kur'an, gjendja e këtyre popujve tregohet kështu:

A e vërejtën ata sa gjenerata para tyre i shkatërruam që Ne u patëm mundësuar atyre (komoditet) në tokë çfarë juve nuk ju mundësuar; u patëm lëshuar nga qielli shi me bollëk dhe u patëm bërë që të rrjedhin lumenj ndër ta, e për shkak të mëkateve të tyre i shkatërruam dhe pas tyre sollëm (breza) të tjerë. (Sure En'am:6)

Në kapitujt e ardhshëm, do të flasim në sjelljen shembullore të profetëve që luftuan kundër këtyre popujve të pabindur.

Njeriu dhe i Dërguari i parë : Ademi

Sic do t'ju kujtohet, kur ishim duke folur mbi krijimin e njeriut, thamë se njeriu i parë në tokë ishte Ademi, paqja qoftë mbi të. Ademi ishte gjithashtu edhe profeti i parë. Domethënë, Allahu kishte dërguar profetë që në bashkësinë e parë që Ai krijoi në faqen e tokës dhe u mësoi atyre fenë dhe si të bëhen shërbëtorë të devotshëm të Allahut.

Allahu e mësoi Ademin të flasë dhe i mësoi atij emrat e të gjitha sendeve. Kjo tregohet në Kur'an si vijon:

E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve)... (Bekare:31)

Kjo sigurisht është gjë shumë e rëndësishme. Në mesin e të gjitha qenieve të gjalla, vetëm njeriu ka aftësi të flasë. Të folurit është veti e veçantë për njerëzit. Falë faktit se Allahu fillimisht ia dha këtë aftësi Ademit, u bë e mundur që njeriu të njohë të gjitha sendet përreth dhe t'u caktojë emra.

Brezat pas Ademit mund të flisnin gjithashtu, kishin ndjenja, ndienin keqardhje apo shqetësim, vishnin rroba, përdornin vegla dhe aparate si dhe kishin talent për muzikë dhe arte. Instrumentet muzikore si flauti, vizatimet në mure dhe objekte të tjera që kanë zbuluar



Në këtë libër, ju mund të lexoni për pavërtetësinë e teorisë së evolucionit, e cila pohon se të gjitha qeniet e gjalla erdhën në jetë rastësisht.



Midis milingonave, bretkosave, apo peshqve që jetojnë në kohën tonë nuk ka asnjë dallim me të afërmit e tyre fosile të shfaqur në figurat përkatëse.

shkencëtarët dëshmojnë se ata ishin njerëz sikur ne. Me fjalë të tjera, ndryshe nga pohimet e disa njerëzve, njerëzit e parë kurrë nuk kanë qenë krijesa të egra, gjysmë majmun-gjysmë njeri.

E dini se, as majmuni e as ndonjë qenie tjetër nuk mund të flasë, të mendojë apo të sillet si njeriu. Allahu ia ka dhënë këto aftësi vetëm njeriut. (Për më shumë dije në lidhje me këtë temë mund të lexoni librin “Mrekullitë e krijimit të Allahut” nga Harun Jahja).

Por, disa njerëz që nuk kanë dëshirë që të pranojnë faktin se njeriu i parë ishte Ademi, parashtruan disa pohime të tyre: Ata shpikën prejardhje të rremë për njeriun e parë. Sipas këtyre skenarëve të imagjinuar, njerëzit dhe majmunët rrjedhin nga një qenie e përbashkët, domethënë, kanë paraardhës të përbashkët, i cili ka evoluar gjatë

kohës deri në gjendjen në të cilën janë sot. Nëse pyet se, si ka ndodhur kjo ngjarje e pazakonshme, ata të japin këtë përgjigje: “Ka ndodhur rastësisht.” Nëse pyet se, a ka ndonjë provë që ta vërtetojë këtë pohim, ata nuk mund të sigurojnë asgjë. Si përfundim, nuk ka asnjë gjurmë që tregon se njeriu ka evoluar nga një qenie tjetër. Nëse pyesni, “Çfarë janë këto gjurmë nga e kaluara?” Përgjigjen e kanë të gatshme: Disa qenie të gjalla lënë gjurmë pasi vdesin, dhe këto gjurmë, që ne i quajmë fosile, mbeten të pandryshueshme për miliona vjet. Sidoqoftë, që të ndodhë kjo, gjallesa duhet të mbulohet befaz dhe të mbetet në një ambient pa oksigjen. Për shembull, nëse një zog në tokë mbulohet befaz nga një grumbull i madh gurësh para miliona vjetësh, fosilja e



këtij zogu do të mund të ruhej deri më sot. Ngjashëm, ka lëndë që tajitet nga drurët, e cila quhet rrëshirë. Nganjëherë, kjo lëndë, që duket si mjaltë, mbulon insektin dhe e shndërron atë në material të fortë të quajtur qelibar, i cili ruan insektet e ngordhura për miliona vjet. Në këtë mënyrë, mblidhet informacioni për qeniet e gjalla nga kohërat e lashta. Gjurmë të tilla quhen "fosile". Ata që sugjerojnë se, njeriu i parë ka lindur nga një krijesë e ngjashme me majmunin, kurrë nuk kanë gjetur asnjë fosil që të dëshmojnë këtë pohim. Me fjalë të tjera, askush nuk ka gjetur ndonjë fosil të ndonjë krijese të pazakonshme si gjysmë majmungjysmë njeri. Por, këta njerëz kanë prodhuar fosile, vizatime dhe piktura të rreme që ta mbulojnë këtë gënjeshtër, madje i kanë vendosur në librat shkollorë.

Të gjitha këto mashtrime janë zbuluar një nga një dhe janë bërë publike si mashtrime shkencore. Për shkak se njerëz të tillë janë të pamatur dhe kokëfortë, është gati e pamundur për ta që të pranojnë qenien e Allahut dhe të kuptojnë se Ai krijoi të gjitha. Edhe pse numri i njerëzve të tillë vazhdimisht vjen duke u zvogëluar, ende ka disa që përpiqen t'i shpërndajnë pikëpamjet e tyre me të meta nëpërmjet revistave periodike, librave dhe gazetave, e gjithashtu, edhe nëpër shkolla. Në mënyrë që t'i bëjnë njerëzit të besojnë këto pikëpamje të tilla të çala, ata këmbëngulin në argumentat e tyre dhe pohojnë se ato kanë vlefshmëri shkencore. Sidoqoftë, çdo studim i kryer dhe dëshmi e siguruar nga shkenctarët inteligjentë vërtetojnë se majmuni nuk ka mundur që të evoluojë në njeri.

Ademi, njeriu i parë, të cilin Allahu e krijoi të veçantë, ishte në çdo

pikëpamje i njëjtë sikurse edhe njeriu i sotëm; ai nuk ishte ndryshe. Këto janë fakte që Allahu na i shpalli neve në Kur'an. Është edhe një çështje tjetër shumë interesante që Allahu na e bën me dije: Tregimi për Ademin dhe Shejtanin (djallin), si armik i njeriut.

Armiku më i madh i njeriut: Djalli

Ju mund të dini diçka për djallin, por, a dini se edhe ai ju njeh shumë mirë juve dhe përdor çdo mënyrë për t'ju tunduar? A e dini se qëllimi i vërtetë i djallit, i cili shtiret se ju ka miq, është që t'ju mashtrojë? Le ta nisim nga fillimi dhe të sjellim ndër mend pse djalli është armik i yni. Për këtë qëllim, le t'i kthehemi tregimit për Ademin dhe djallin në Kur'an.

Në Kur'an, djalli është emër i përgjithshëm i të gjitha qenieve që i kanë vënë vetes detyrë që ta largojnë njeriun nga udha e drejtë deri në Ditën e Gjykimit. Iblisi është qenia kryesore e keqe, i cili ngriti krye kundër Allahut kur Ai krijoi Ademin. Sipas tregimeve në Kur'an, Allahu e krijoi Ademin, e mandej, i thirri engjëjt që të përkulen para tij. Engjëjt iu bindën urdhërit të Allahut, përpos Iblisit, i cili refuzoi që t'i përkulej. Ai me paturpësinë më të madhe mendonte se ishte më i lartë se njeriu. Për shkak të mosbindjes dhe pafytyrësisë së tij, ai u dëbua nga mëshira e Allahut. Para se të largohej nga prania e Allahut, Iblisi kërkoi kohë nga Allahu që t'i largojë njerëzit nga udha e drejtë. Qëllimi i Iblisit është që t'i tundojë njerëzit dhe, në këtë mënyrë, ata të largohen nga rruga e vërtetë brenda kohës që u është dhuruar. Ai do të bëjë çmos që të bëjë sa më shumë njerëz për vete. Allahu njofton se Ai do ta dërgojë

djallin dhe pasuesit e tij në Zjarr. Këto tregohen në Kur'an kështu:

Ne ju krijuam pastaj ju dhamë formën, e mandej engjëjve u thamë: "Bëni sexhde për Ademin". Ata i bënë sexhde pos Iblisit. Ai nuk qe prej atyre që bënë sexhde. (All-llahu) Tha: "Çka të pengoi ty të bësh sexhde, kur Unë të urdhërova?" Ai (Iblisi) tha: "Unë jam më i vlefshëm se ai, më krijove mua nga zjarri, e atë e krijove nga balta!" (All-llahu) Tha: "Zbrit nga ai (Xhenneti), nuk të takon të bësh kryelartësi në të, dil jashtë, s'ka dyshim ti je i poshtëruar". (Iblisi) Tha: "Më afatizo gjer ditën kur ringjallen (njerëzit)!" (All-llahu) Tha: "Ti je i Afatizuar!" (Iblisi) Tha: "Për shkak se më humbe mua, unë do t'u ulem atyre (do t'u zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë. Mandej, do t'ju sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjesh që të falënderojnë (të besojnë)!" (All-llahu) Tha: "Dil nga ai (Xhenneti), i urrejtur, i dëbuar. Kush prej tyre vjen pas teje, Unë kam për ta mbushur Xhehennemin me të gjithë ju. (A'raf:11-18)

Pasi u dëbua nga mëshira e Allahut, djalli filloi luftën që do të zgjasë deri në Ditën e Gjykimit. Qysh atëherë, ai në mënyrë tinzare u afrohet njerëzve, bën plane si t'i largojë nga rruga e drejtë dhe përdor mënyra të pashembullta për këtë qëllim. Siç mund ta keni kuptuar më mirë, djalli është një armik që mund t'i afrohet njeriut shumë tinëzisht. Për këtë arsye, duhet të jeni shumë syçelët që t'i shmangeni atij. Kurrë mos harroni se, djalli shtron kurthe madje edhe tani, duke planifikuar që të të mashtrojë. Ai përpiket që të të ndalojë që ta lexosh këtë libër dhe të mendosh në lidhje për atë çfarë lexove deri tani. Ai përpiket që të të pengojë të bësh vepra të mira, dhe të bëhesh mosrespektues dhe i

padëgjueshëm ndaj më të moshuarve, ai të pengon që ta falenderosh Allahun, të falesh dhe të tregosh gjithmonë të vërtetën.

Kurrë mos lejo që të të mashtrojë djalli dhe të të pengojë të bëhesh një njeri me karakter të mirë si dhe të dëgjosh ndërgjegjen tënde. Kur të vijne mendime të këqija apo kur të jesh pa vullnet për të kryer punë të mira, duhet që të kërkosh strehim tek Allahu dhe ndihmë nga Ai, pasi, të gjitha këto janë kurthe tinëzare të djallit. Kurrë mos harro se, djalli nuk mund t'u bëjë asgjë atyre që janë besimtarë të fortë.


Profeti Nuh (Noa)

Nuhu, paqja qoftë mbi të, sikurse të gjithë profetët tjerë, i ftoi njerëzit e tij në rrugë të drejtë. Ai iu tha atyre se, duhet që të kenë besim tek Allahu, se Ai është Krijues i çdo gjëje, se duhet adhuruar vetëm Ai, se, përndryshe, do të dënohen. Kjo tregohet në Kur'an në këtë mënyrë:


Ne patëm dërguar edhe Nuhun te populli i vet (me porosi të njëjtë si Muhammedin që t'u thotë): Unë ju tërheq vërejtjen haptazi. Që të mos adhuronit tjetër kënd pos All-llahut, sepse unë kam frikë për dënimin tuaj në ditën e pikëllueshme. (Hud:25-26)

Përkundër të gjitha paralajmërimeve, vetëm disa njerëz i besuan Nuhut. Pas kësaj, Allahu urdhëroi Nuhun që të ndërtojë një anije të madhe. Allahu e njoftoi atë se besimtarët do të shpëtojnë në atë anije.

Nuhu filloi që të ndërtojë një anije megjithëse në atë vend nuk kishte det saqë, i befasoi ata njerëz që nuk besonin Allahun, dhe ata filluan ta përqeshnin. Ata që nuk besonin nuk e dinin se çfarë do t'u ndodhte, por Allahu e dinte. Kur u krye ndërtimi i anijes, ra një shi i rrëmbyeshëm për shumë ditë saqë uji arriti një nivel shumë të lartë mbi



tokë, dhe përmyti gjithçka. Kjo fatkeqësi historike është vërtetuar prej shumë shkencëtarëve. Në Lindjen e Mesme, është dëshmuar se malet e sotme, dikur, ishin të mbuluar me ujë. Në televizor, sigurisht që keni parë shumë përmytje në skaje të ndryshme të botës. Njerëzit, zakonisht, kur përballen me këtë fatkeqësi, ngjiten mbi pullaz dhe presin për ndihmë. Në këso raste, vetëm barka apo helikopteri mund të jetë ndihmë. Në kohën e profetit Nuh, paqja qoftë mbi të, vetëm anija mund të ishte shpëtim. Kjo fatkeqësi e quajtur "Përmytja e Nuhut", në të vërtetë ishte një dënim i përgatitur nga Allahu, në mënyrë që të dënoheshin njerëzit që nuk i besuan Nuhut. Për shkak se ata prisnin



ndihmë prej dikujt tjetër e jo prej Allahut, asnjëri nga këta njerëz përbuzës që e bënë veshin të shurdhët ndaj paralajmërimeve të Allahut, nuk hipën në anijen e Nuhut. Ata nuk u mbështetën tek Allahu, por në qenie të tjera. Nëse nuk dëshiron Allahu, asgjë nuk mund të na mbrojë. Njerëzit që e mohonin këtë, hipën mbi male apo në vende të larta, por prapëseprapë, nuk mundën që të shpëtonin nga përmytja. Vetëm disa njerëz e besuan Allahun dhe ky besim i bëri ata që të hipin në anije dhe të shpëtojnë së bashku me Nuhun. Duke iu bindur urdhërave të Allahut, ata morën një çift nga çdo lloj kafshe me vete. Kjo tregohet kështu në Kur'an:



Populli i Nuhut që ishte para tyre përgënjeshtroi, dhe robin Tonë (Nuhun) e quajti rrenacak dhe thanë: "I marrë!" dhe iu bë kërcënim. E ai iu drejtua Zotit të vet: "Unë jam i mundur, prandaj më ndihmo!" Atëherë Ne me një shi të vrullshëm i hapëm dyert e qiellit. Dhe Ne tokën e zbërthyem në burime uji, kurse uji u bashkua siç ishte caktuar. E atë (Nuhun) e bartëm në (anije) dërrasash e shtyllash të



gojëzuara. Që lundronte në mbikëqyrjen Tonë. (I fundosëm) Si ndëshkim për atë (Nuhun) që ishte mohuar (përbuzur). Atë (ngjarje) Ne e lamë kujtim, po a ka ndokush që merr mësim? E çfarë ishte ndëshkimi Im dhe kërcënimi Im! (Kamer:9-19)

Të gjithë të dërguarit u janë dërguar popujve të veçantë dhe komunikonin kryesisht të njëjtat mësimë dhe e ftonin popullin e tyre që ta adhuronin Allahun dhe t'u bindeshin profetëve. Si shpërblim për shërbimet që kryenin, ata nuk kërkonin para, pasi njerëzit e dërguar nga Allahu për të shpallur Fjalën e Tij nuk e bëjnë një gjë të tillë. Ata i kryenin shërbimet e tyre sepse e donin Allahun dhe i frikësoheshin Atij. Ndërkohë, ata përballëshin me shumë vështirësi: populli i tyre i përgojonte dhe i torturonte. Përveç kësaj, disa njerëz mundoheshin dhe bënë intriga për t'i vrarë profetët që u ishin dërguar atyre, e disa prej tyre madje morën guximin edhe ta bëjnë këtë. Sidoqoftë, pasi profetët i frikësoheshin vetëm Allahut dhe askujt tjetër, asnjë vuajtje nuk i zbrapsi. Ata kurrë nuk harruan se Allahu do t'i shpërblejë shumë në këtë jetë dhe në jetën e përtejme.

Profeti Ibrahim (Abraham)

Në këtë kapitull, do të ndalemi në vetitë e ndryshme të disa profetëve për të cilët edhe Allahu na e tërheq vërejtjen në Kur'an. Ibrahim, paqja qoftë mbi të, ishte njëri nga ata profetë. Kur ishte i ri dhe nuk kishte pranë askënd që ta përkujtonte për ekzistencën e Allahut, ai vështroi me vëmendje qiellin dhe, kështu, arriti në përfundimin se, Allahu ka krijuar çdo gjë. Kjo tregohet në Kur'an kështu:

E kur atë e mbuloi nata, ai pa një yll e tha: "Ky është Zoti im!" E kur u zhduk ai (perëndoi) tha: "Unë nuk i dua ata që humbin". Kur e pa Hënën të porsalindur tha: "Ky është Zoti im! e kur perëndoi ajo, tha: Nëse Zoti im nuk më udhëzon, unë do të jem prej njerëzve të



humbur!" Kur e pa Diellin të lindur, tha: "Ky është Zoti im, ky është i madh!" e kur ai perëndoi, tha: O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju i shoqëroni!" Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt e tokën, larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë shok! (En'Am: 76-79)

Ibrahimi, paqja qoftë mbi të, u tha njerëzve që mos adhurojnë askënd përpos Allahut:

Lexoju (nga ajo që të shpallëm ty Muhammed) atyre ngjarjen e Ibrahimit. Kur i tha babait të vet dhe popullit të vet: "Çka jeni duke adhuruar?" Ata i thanë: "Adhurojmë idhuj, vazhdimisht u jemi besnikë atyre!" Ai i tha: "A ju dëgjojnë ata juve kur u luteni?" Ose, "A u sjellin juve dobi apo dëm?" Ata thanë: "Jo, por kështu i gjetëm që bënin edhe prindërit tanë!" Ai tha: "A po shihni se ç'po adhuronit?" Ju dhe prindërit tuaj të mëparshëm, Në të vërtetë, ata (që adhuronit ju) janë armiq të mij, përveç Zotit të botëve (nëse

përveç idhujve adhuroni edhe Atë). Zoti që më krijoi, Ai më udhëzon mua, Dhe Ai që më ushqen dhe më jep të pi Dhe kur të sëmurem Ai më shëron, Ai më bën të vdes e mandej më ngjall, Ai tek i cili kam shpresë se do të m'i falë mëkatet e mia në Ditën e Gjykimit. (Shuara:69-82)

Armiqtë e Ibrahimit u përpoqën që ta vrasin atë kur ai i ftonë në besimin tek Allahu. Ata ndezën një zjarr të madh dhe e hodhën aty. Por, Allahu e mbrojti atë dhe e ruajti nga zjarri. Kjo, në Kur'an, tregohet kështu:

Po përgjigjia e popullit të tij nuk ishte tjetër vetëm duke thënë: "Mbyteni atë (Ibrahimin) ose digjeni!" Mirëpo, Allahu e shpëtoi atë prej zjarrit. Për një popull që beson, këtu vërtet ka fakte bindëse. (Ankebut:24)



Po Ne i thamë: "O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!"
(Enbija:69)

Allahu është Ai që krijon dhe kontrollon çdo gjë. Me vullnetin e Allahut flaka nuk e dogji Ibrahimin. Kjo është një mrekulli e Allahut dhe shfaqje e fuqisë së Tij. Çdo gjë në tokë ndodh me vullnetin e Allahut. Asgjë nuk ndodh pa vullnetin dhe kontrollin e Tij. Nëse Ai nuk dëshiron, asgjë nuk mund të bëjë dëm apo të vrasë ndonjë njeri. Për këtë, Allahu na njofton në Kur'an:

Askush nuk vdes pa vullnetin dhe lejen e All-llahut. Ai është shënim i afatit të caktuar. (Ali Imran:145)

Ai nuk vdiq edhe pse ishte hedhur në zjarr, pasi afati i caktuar për vdekje nga Allahu nuk i kishte ardhur. Allahu e shpëtoi nga zjarri. Në një ajet, Allahu tregon se Ibrahim i kishte një karakter të shkëlqyer:

Vërtet, Ibrahim i ishte shumë i butë, shumë i dhembshur dhe pendestar. (Hud:75)

Allahu i do njerëzit që janë të devotshëm ndaj Tij me gjithë zemër. Siç sqaron ajeti, të mosqenurit kryelartë, por, me karakter të mirë dhe i nënshtruar ndaj urdhërave të Allahut janë ndër vetitë më të pëlqyeshme para Allahut.



Profeti Musa (Moisi)

Musa, paqja qoftë mbi të, është profeti që Allahu shpesh e përmend në Kur'an. Allahu ia shpalli Musait Teuratin. Por, në ditët e sotme, Teurati i çifutëve dhe Dhjata e Vjetër e Biblës së krishtere kanë humbur origjinalitetin e tyre, pasi njerëzit shtuan më vonë fjalë të tjera dhe kështu ato mbetën në to. Por, çifutët dhe të krishterët, ende, sot i lexojnë këto libra të ndryshuar duke menduar se janë libra origjinalë të shpallur nga Allahu. Çifutët kanë devijuar nga rruga e drejtë pasi libri që ata besojnë, nuk është libri i sjellë nga profeti Musa, paqja qoftë mbi të.

Gjithçka për jetën dhe karakterin e mirë të Musait e mësojmë nga Kur'ani. Siç na njofton Kur'ani, mbretërit e Egjiptit të vjetër qheshin "faraonë". Shumica e faraonëve ishin njerëz shumë mendjemëdhenj që nuk besonin Allahun dhe e quanin vetveten zotëra. Allahu dërgoi Musain tek njëri ndër sundimtarët më mizorë. Një pikë e rëndësishme që duhet të ndalemi kur lexojmë vargjet për jetën e Musait është "fati". Ngjarjet në vijim e dërgojnë atë në pallatin e faraonit:

Në kohën kur u lind Musa, faraoni u kishte dhënë urdhër ushtarëve të tij që të vrisnin çdo foshnjë mashkull që lindej në



Pas vdekjes së Musait, disa njerëz qëllimkëqij e ndryshuan Teuratin. Kjo është edhe arsyeja pse Teurati dhe Testamenti i Vjetër, të cilin e lexojnë njerëzit sot, ndryshojnë shumë nga libri origjinal që iu zbrit Musait, paqja qoftë mbi të.

vendin e tij. Musa, paqja qoftë mbi të, ishte njëri ndër ato foshnje që ishin në rrezik. Allahu e frymëzoi nënën e tij që ta lëshonte në një arkë në lumë dhe e siguroi atë se ai do t'i kthehej asaj si profet. Nëna e tij e vendosi Musain në një arkë dhe e lëshoi në lumë. Kjo arkë lundroi mbi ujë derisa u ndal afër pallatit të faraonit, ku e gjeti gruaja e tij. Ajo e mori fëmijën dhe vendosi që ta sillte në pallat. Në këtë mënyrë, duke mos e ditur, faraoni mori përsipër që kujdesej për njeriun, i cili më vonë




Në Egjiptin e lashtë mbreti quhej Faraon. Shumica e faraonëve ishin njerëz shumë arrogantë, të cilët nuk i besonin Allahut dhe e quanin veten e tyre të shenjtë.

do të kumtojë shpalljen e Allahut atij dhe do t'i kundërshtojë pikëpamjet e tij të gabuara. Allahu përfshin gjithçka me dijeninë e Tij, dhe Ai e dinte gjithashtu se faraoni do ta gjente Musain, paqja qoftë mbi të, dhe se do ta dërgonte në pallatin e tij.

Kur u lind Musai, Allahu e dinte se do të braktisej në lumë, se faraoni do ta gjente dhe Musai, përfundimisht, do të bëhej profet. Kështu e kishte përcaktuar Allahu fatin e Musait dhe Ai e lajmëroi nënën e tij. Në këtë pikë i duhet kushtuar vëmendje faktit se, çdo

Bijtë e Israelit u kthyen në sklevër nga Faraoni në Egjipt. Në foton më sipër mund t'i shihni këta njerëz, të cilët ishin të detyruar të kryenin punë tepër të rënda.



ngjarje që ndodhi në jetën e tij ishte në pajtim me fatin që Allahu ia kishte paracaktuar.

Kur u rrit, Musai u largua nga Egjipti. Pas një kohe, Allahu e bëri atë profet dhe të dërguar dhe, si përkrahje, iu dha vëllai i tij, Haruni, paqja qoftë mbi ta.

Të dy, së bashku, shkuan te faraoni dhe ia shpallën atij porosinë e Allahut. Kjo ishte një detyrë shumë e vështirë sepse, pa ngurrim ata thirrën sunduesin mizor që të besonte Allahun dhe ta adhuronte Atë. Kjo thirrje e profetit Musa, paqja qoftë mbi të, tregohet kështu:





Faraoni i i pashpirt i arrestoi ata njerëz që i besuan Musait (paqja qoftë mbi të) dhe i ktheu ata në skllëvër.

Mandej pas tyre dërguam Musain me mrekulli të argumentuara te faraoni dhe rrethi i tij, e ata i refuzuan ato, e shih se si ishte përfundimi i shkatërruesve? Musai tha: "O faraon, s'ka dyshim, unë jam i dërguar prej Zotit të botëve". Është dinjitet për mua ta them për All-llahun vetëm të vërtetën. Unë u kam ardhur me argumente nga Zoti juaj, lejoi pra beni israilët të vijnë me mua!" (A'raf:103-105)

Faraoni ishte një njeri kryelartë dhe mendjemadh. Duke menduar se ai e kishte çdo send nën kontroll, ngriti krye kundër Allahut. Allahu i dhuroi atij të gjithë pasurinë e tij, fuqinë dhe tokat, por faraoni ishte i padijshëm, dhe nuk mundi ta kuptonte këtë. Faraoni kundërshtoi Musain dhe nuk besonte tek Allahu, dhe ishte, siç e përmendëm më lart,

një njeri shumë mizor. Ai i bëri Bijtë e Izraelit (Beni Izraelitët) robër të vet. Kur u bë e qartë se faraoni kishte për qëllim që t'i shfaroste Musain dhe të gjithë besimtarët, ata u larguan nga Egjipti nën udhëheqjen e Musait. Musai, paqja qoftë mbi të, dhe Bijtë e Izraelit mbetën mes detit dhe ushtarëve të faraonit që i ndiqnin. Por, edhe në atë situatë aq të pashpresë, ai nuk u dëshpërua dhe, fare nuk e humbi besimin që kishte tek Allahu. Allahu në mënyrë të mrekullueshme ndau detin në dy pjesë dhe hapi rrugën në det për Bijtë e Izraelit. Kjo ishte njëra ndër mrekullitë më të mëdha që Allahu ia dhuroi Musait. Si arritën bregun tjetër Bijtë e Izraelit, deti u kthye prapë në vendin e vet, duke përmbytur faraonin dhe ushtarët e tij. Allahu e tregon këtë ngjarje të mrekullueshme në Kur'an në këtë mënyrë:



Kur iu bë e qartë se Faraoni po bënte plane për të zhdukur të gjithë besimtarët nga faqja e dheut, ata u larguan për në Egjipt nën udhëheqjen e Musait, (paqja qoftë mbi të).



Musai dhe Bijtë e Israelit mbetën midis valëve të detit dhe ushtarëve të Faraonit që i ndiqnin këmba-këmbës. Por, edhe në këtë situatë të dëshpëruar Musai nuk ngushtua dhe nuk e humbi besimin tek Allahu. Madhërishtëm, Allahu e ndau detin më dysh dhe hapi në të rrugë për Bijtë e Israelit. Kjo ishte një nga mrekullitë më të mëdha që Allahu i dha Musait. Sapo Bijtë e Israelit arritën në bregun tjetër, deti u mbyll duke mbytur kështu Faraonin dhe ushtarët e tij.

Ashtu siç ishte traditë e popullit të faraonit dhe atyre që kishin qenë më parë, që i konsideronin të rreme faktet e Zotit të tyre, e Ne për këto të këqija të tyre i shkatërruam, e popullin e faraonit (edhe faraonin) e fundosëm, por të gjithë këta ishin dëmtues të vetes së tyre. (Enfal: 54)

Në çastin kur faraoni kuptoi se do të vdiste, ai deklaroi se e besoi Allahun në mënyrë që të shpëtonte. Nuk e dimë nëse ky pendim i tij në çastin e fundit nuk kishte ndonjë dobi, pasi Allahu fal vetëm kur pendimi

ynë është i sinqertë dhe para se të vijë çasti i vdekjes. Allahu është i Gjithë-Mëshirshëm. Nëse pendimi bëhet në çastin e vdekjes, natyrisht, nëse nuk është i sinqertë, një pendim i tillë nuk e shpëton njeriun. E njëjta gjë ishte edhe me faraonin. Por, këtë vetëm Allahu e di. Siç shihet nga ky tregim, duhet të jetojmë që mënyrë të tillë që të fitojmë kënaqësinë e Allahut gjatë jetës sonë dhe mos të bëjmë të njëjtin gabim si faraoni. Nëse dështojmë në këtë, pendimi në çastin e vdekjes mund të mos ketë dobi.

Profeti Junus (Jona)

Pa marrë parasysh sa e pashpresë dhe e vështirë të jetë situata, njeriu duhet gjithmonë të ketë besim tek Allahu dhe të kërkojnë ndihmë nga Ai. Siç përmendëm në pjesën më lart, Musai, paqja qoftë mbi të, kurrë nuk e humbi shpresën edhe pse mbeti i bllokuar mes ushtrisë së faraonit dhe Detit të Kuq, por ai kishte besimin tek Allahu. Junusi, paqja qoftë mbi të, gjithashtu është shembull i një karakteri të mirë. Edhe pse ishte caktuar nga Allahu që ta paralajmërojë popullin e vet, Junusi, paqja qoftë mbi të, e la popullin e vet pa paralajmërim. Kështu që, Allahu e sprovoi në mënyra të ndryshme: së pari, ai u hodh në det nga anija në të cilën lundronte. Pastaj një peshk i madh e gëlltiti. Kjo bëri që të ndiejë pendim të thellë për sjelljet e veta; ai me pendim u kthye tek Allahu, kërkoi strehim tek Ai dhe iu fal Atij. Kjo tregohet kështu në Kur'an:


(Përkujto) Edhe atë të peshkut (Junusin) kur doli i hidhëruar (prej popullit) dhe mendoi se nuk do t'i vijë më puna ngushtë, po në

errësira ai tha se: "Nuk ka Zot pos Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejt vetes!" Ne iu përgjigjëm atij, e shpëtuan nga tmerri. Kështu i shpëtojmë Ne besimtarët. (Enbija:87-88)

Në Kur'an, Allahu tregon se çfarë do t'i ndodhte atij nëse nuk do të kishte besim në Allahun dhe nuk do të falej:

E sikur të mos kishte qenë prej atyre që përmendin shumë e Allahun, do të mbetej në barkun e tij deri në ditën e ringjalljes. E Ne e hodhëm në një tokë pa bimë (shkretëtirë) dhe ai ishte i sëmurë. Dhe Ne bëmë që për të të mbijë një bimë (t'i bëjë hije) nga kungulli. Ne (pastaj) e dërguam atë te njëqindmijë e më shumë. (Saffat:143-147)

Junusi u hodh nga një anije në det.
Më pas, e gëlltiti një peshk gjigand.
Allahu e shpëtoi Junusin (paqja qoftë
mbi të) nga ajo gjendje e pashpresë.



Allahu e shpëtoi Junusin nga një situatë me të vërtetë e pashpresë. Kjo është një shenjë e qartë se askush nuk duhet që të humbë besimin në ndihmën e Allahut. Përjetimi i Junusit, paqja qoftë mbi të, është mësim për të gjithë besimtarët: ne nuk duhet kurrë që të bëhemi të plogësht, pa marrë parasysh se me çfarë vështirësie ballafaqohemi, por, gjithmonë duhet t'i lutemi Allahut dhe të kërkojmë ndihmë nga Ai.

Profeti Jusuf (Jozef)

Në Kur'an, mund të gjejmë tregimin me hollësi për jetën e Jusufit, paqja qoftë mbi të. Këtu mund ta përshkruajmë shkurtimisht dhe të shohim karakterin shembullor të tij.



Jusufi ishte njëri nga bijtë e Jakubit, paqja qoftë mbi të. Kur ishte shumë i ri, vëllezërit e tij e hodhën në një pus, sepse e kishin zili, dhe i thanë të atit se e hëngrën ujqërit.

Udhëtarët e një karvani e gjetën në pus dhe e shitën atë në pallatin e një njeriu fisnik në Egjipt. Atje, më vonë, shpifën kundër tij dhe e futën në burg, ku qëndroi me vite të tëra.

Më në fund u shpall i pafajshëm dhe u lirua. Duke qenë një njeri i mençur dhe i besueshëm edhe për shkak se ishte krejtësisht i pafajshëm, sunduesi i Egjiptit i vendosi pasuritë dhe depot nën drejtimin e tij.

Më në fund, Jusufi i fali vëllezërit e tij, të cilët ishin treguar shumë mizorë me të dhe i mori ata si dhe nënën dhe babain që të jetonin me të. Jusufi, paqja qoftë mbi të, kishte një karakter shembullor. Allahu e vuri atë në sprova të ndryshme, e shpëtoi nga pusi në të cilin ishte e pamundur që të dilej, e shpëtoi nga situata e keqe me dërgimin e e tij



Udhëtarët e një karvani e gjetën Jusufin në një pus dhe e shitën në pallatin e një fisniku në Egjipt.

në burg e pastaj e shpëtoi atë nga burgu duke e vënë në vend nderin e tij, dhe përfundimisht i dhuroi gradë të lartë. Në çdo situatë, Jusufi, paqja qoftë mbi të, i kthehej Allahut dhe i lutej. Megjithë pafajësinë e tij ai qëndroi në burg për disa vite, megjithatë nuk harroi asnjëherë se ajo s'ishte gjë tjetër veçse një sprovë nga Allahu. Edhe në burg ai u fliste njerëzve që kishte përreth për forcën dhe madhështinë e Allahut. Besnikëria e tij dhe besimi tek Allahu edhe në kushte aq të vështira flasin vetë për karakterin e tij të shkëlqyeshëm.

Profeti Ejub (Jobi)

Të qenit i patundur në të gjitha situatat është një veti e rëndësishme tipike për muslimanët. Ejubi, paqja qoftë mbi të, u sprovua me humbje të familjes dhe pasurisë së tij, dhe një sëmundje të rëndë, që i solli shumë vuajtje. Ai vetëm kërkonte ndihmën e Allahut dhe mbështetej në Të. Allahu iu përgjigj lutjeve të tij dhe e mësoi atë se si të shërohej. Karakteri shembullor i Ejubit, paqja qoftë mbi të, si dhe lutja e tij tregohet në Kur'an kështu:

Përkujto edhe robin tonë Ejubin, kur me lutje iu drejtua Zotit të vet: "Djalli më ka goditur me mundim e dhimbje!" (iu tha) "Bjeri me këmbën tënde tokës! Ky është (ujë) i ftohtë, lahesh dhe pi".

...Ne e gjetëm atë të durueshëm. Sa rob i mrekullueshëm ishte ai! Ai vërtet kthehej te Zoti. (Sad: 41-44)

Shumë shpejt pasi na kaplon sëmundja, vështirësitë apo problemet, menjëherë na pushton mërzia. Madje, disa njerëz bëhen kryelartë ndaj Allahut. Megjithatë, këto qëndrime shkaktojnë pakënaqësi tek Allahu. Siç tregon shembulli i Ejubit, Allahu mund t'i



dërgojë prova të ndryshme robërve të Vet, por shqetësime të tilla e forcojnë besimtarin dhe vënë në provë devotshmërinë e tij ndaj Allahut. Kur përjetojmë shqetësime duhet të lutemi dhe duhet të kemi besim tek Allahu. Duhet të jemi të durueshëm sikurse Ejubi, paqja qoftë mbi të, dhe t'i drejtohemi Allahut. Vetëm atëherë, Allahu do të na i lehtësojë shqetësimet dhe do të na shpërblejë në të dyja botërat.

Profeti Isa (Jezusi)

Allahu e krijoi Isain, paqja qoftë mbi të, në një mënyrë të veçantë. Ashtu si në rastin e Ademit, Allahu e krijoi pa baba. Kjo tregohet kështu në Kur'an:

Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) te All-llahu është sikurse

çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha:

"Bëhu!" ai u bë. (Ali-Imran: 59)

Në Kur'an Isa, paqja qoftë mbi të, quhet edhe "biri i Merjemes". Merjemja ishte një grua fisnike, të cilën Allahu e jep si shembull për të gjitha gratë. Ajo ishte grua e pastër dhe besimtare e devotshme. Allahu ia dhuroi asaj Isain nëpërmjet engjëllit Xhibril, në mënyrë të mrekullueshme pa baba, si dhe i dha sihariqin se djali i saj do të bëhej profet.

Allahu e bëri Isain profet dhe i shpalli atij Inxhilin, njëri ndër librat që Allahu i shpalli njerëzimit. (Pas Isait, Inxhili po ashtu është ndryshuar nga njerëzit. Sot, nuk e kemi Inxhilin e vërtetë, dhe librat që të krishterët i quajnë Ungjij nuk janë të besueshëm.)

Allahu urdhëroi Isain që t'i ftonte njerëzit në rrugë të vërtetë dhe i dhuroi shumë mrekullira. Ai foli kur ishte në djep dhe u tregoi njerëzve për Allahun. Isai gjithashtu na dha sihariqin për ardhjen e Muhammedit (Ahmedit), paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, të dërguarin e Allahut që do ta pasonte, e që tregohet në Kur'an kështu:

Dhe kur Isai, biri i Merjemes tha: "O beni israilë, unë jam i dërguar i Allahut te ju. Jam vërtetues i Teuratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!" E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: "Kjo është magji e hapët". (Saff: 6)


Në kohën e tij, vetëm disa njerëz i besuan Isait dhe e ndihmuan atë. Armiqtë e Isain bënë plane që ta vrisnin. Ata mendonin se e kapën dhe e kryqëzuan. Por, në Kur'an, Allahu na tregon se ata nuk e vranë atë:

Madje për shkak të thënies së tyre: "Ne e kemi mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e All-llahut". Po ata as nuk e mbytën, as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytyjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytyje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbytën atë. (Nisa:157)

Pas Isait, paqja qoftë mbi të, armiqtë e tij u përpoqën që ta ndërronin shpalljen që ai solli. Ata filluan që ta përshkruajnë Isanë dhe Merjemen si qenie mbinatyrore, bile edhe si "zotëra". Edhe sot ende, ka njerëz që ende besojnë në këto besime të gabuara. Për fjalët e Isait, Allahu na njofton në Kur'an se këto janë besime të gabuara:

Dhe kur All-llahu tha: "O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: "Më besoni mua dhe nënës time dy zota pos All-llahut!?" (Isai) Tha: "Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, Ti do ta dije. Ti e di ç'ka në mua, e unë nuk di ç'ka në Ty. Ti je më i dijsmi i të fshehtave!" Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, pos asaj që Ti më urdhërove; ta adhuron All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj dhe sa isha ndër ta, kam qenë përcjellës i tyre, e pasi që më more mua, Ti ishe roje (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send!" (Maide:116-117)





*Rasti i Isait tek Allahu është
njëlloj sikur rasti i Ademit: e
krijoi nga dheu e pastaj i tha :
“Bëhu!” dhe ai u bë.
(Sure Ali Imran: 59)*

Pas Isait, numri i njerëzve që besuan në të u rrit, por edhe sot janë në rrugë të gabuar pasi ata pasojnë Biblën, e cila ka pësuar ndryshime nëpërmjet shtesave dhe fshirjeve.

E vetmja rrugë që ka mbetur sot, është rruga e profetit Muhammed, paqja qoftë mbi të, e cila na fton të gjithë neve të besojmë në Kur'an, sepse është e vetmja shpallje e pandryshuar e Allahut.

I Dërguari i Allahut: Muhammedi

Ne dimë më shumë për të dërguarin e Allahut, Muhammedin, paqja qoftë mbi të, sepse është profeti i fundit dhe ka jetuar para 1.400 vjetëve. Njerëzit ndryshuan dhe e shtrembëruan të gjitha fetë që Allahu i shpalli para tij. Ja pse, Libri i fundit për të cilin njerëzit mbajnë përgjegjësi deri në Ditën e Gjykimit i është zbritur profetit tonë: që të përmirësojë të gjitha gabimet që kishin hyrë në fetë e vjetra. Allahu njoftoi se çfarë kërkon nga robët e Vet përmes Kur'anit. Profeti ynë,




paqja qoftë mbi të, gjithashtu ka hasur shumë vështirësi kur ua komunikoi porosinë e Allahut popullit të tij.

Shumë akuza të pabaza që ishin bërë kundër tij, përkundër faktit se ai nuk kërkonte që të paguhej nga njerëzit dhe se nuk kishte interesa të kësaj bote. Ai ishte detyruar që të shpërngulej nga Meka, qyteti i lindjes. Muslimanët e parë që e pasuan ishin gjithashtu të ndjekur, bile disa edhe të torturuar dhe nënshtruar keqtrajtimeve të egra. Por, Allahu nuk lejoi që jobesimtarët të dëmtojnë fenë islame, që ka mbetur e pandryshuar deri në ditët e sotme. Në përputhje me premtimin e Allahut, çdo fjalë në Kur'an ka mbetur krejtësisht e paprekur. Thirrja e profetit Muhammed, paqja qoftë mbi të, gjithashtu iu drejtohet edhe njerëzve kohës së sotme. Allahu ka urdhëruar të gjithë njerëzit që t'iu binden të dërguarve dhe, në shumë ajete, thekson se, duke iu bindur të dërguarve të Tij në të vërtetë i binden Atij. Për këtë shkak, bindja ndaj profetit tonë është njëra ndër parimet më të rëndësishme dhe thelbësore islame. Bindja e sinqertë ndaj urdhërave të profetit tonë, paqja qoftë mbi të, sigurisht është shfaqje i bindjes ndaj Allahut. Në Kur'an, Allahu prezanton vetitë e mrekullueshme të profetit tonë, që është shembull për të gjithë njerëzit. Ja disa ajete në lidhje me këtë:

Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët. (Teube:128)

Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijshtëm për çdo send. (Ahzab:40)



*Ju ka ardhur një Profet nga
mesi juaj, i vjen rëndë që do ta
vëni në mundime, mezi pret të
niseni rrugës së drejtë, sepse
është i butë dhe mëshirëplotë
ndaj besimtarëve.
(Sure Teube: 128)*



Është e vërtetë se All-llahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe shariatën, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur. (Ali Imran: 164)

Në ajetet kur fillohet me fjalën, “Thuaj...,” Allahu urdhëron profetin Muhammed se si të komunikojë porosinë e Tij. Përmes këtyre ajeteve dhe ajeteve të tjera, profeti ynë, paqja qoftë mbi të, ua komunikoi njerëzve porosinë e Allahut. Gruaja e tij, Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë, “Karakteri i tij ishte Kur'ani”. Ajo mendonte se ai e mishëronte Kur'anin, dhe ne e dimë se Sunneti është zbatimi në praktikë i Kur'anit. Në një ajet, Allahu thotë se ata robër që kanë frikë Allahun dhe dëshirojnë që të falen duhet që t'i binden të dërguarit të Allahut, paqja qoftë mbi të:

Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu të ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë. (Ali Imran:31)

Siç përmendëm në ajetin e mësipërm, nëse dëshirojmë që Allahu të na dojë, ne duhet që të përmbushim atë çfarë na ka porositur profeti ynë dhe ta zbatojmë me përpikmëri.



MREKULLITË E KUR'ANIT

Më lart përmendëm se mrekullia më e madhe që i është dhënë profetit tonë, paqja qoftë mbi të, është Kur'ani. Kur'ani i është dërguar njerëzimit para 1.400 vjetësh, por në të shkruhen disa të vërteta të cilat janë zbuluar vetëm kohët e fundit. Që nga planetet e deri tek yjet, nga njerëzit deri tek kafshët, Allahu krijoi çdo gjë në gjithësi. Zoti ynë di çdo gjë që deri tani nuk është zbuluar dhe na njofton për këtë në Kur'an. Ne mund t'i mësojmë ato vetëm kur na jep leje Allahu, dhe atëherë e kuptojmë se ato janë mrekulli prej Allahut. Kur'ani përmban shumë mrekulli shkencore. Këtu ne do të përqendrohemi vetëm në disa mrekulli shkencore të Kur'anit. *(Për dije më të hollësishme, mund të lexoni librin "Mrekullitë e Kur'anit").*

Si ka lindur universi

Prejardhja e gjithësisë përshkruhet në Kur'an si në këtë ajet ashtu edhe në disa tjerë:

Ai (All-llahu) është që krijoi (pa kurrfarë shembulli) qiejt dhe tokën...

(En'Am: 101)

Në pjesën e parë të këtij libri, shpjeguar me hollësi se si ka lindur universi nga asgjëja para 15 miliardë vjetësh. Me fjalë të tjera, universi befasisht lindi nga asgjëja.

Vetëm shkencat e shek. të 20-të na e kanë bërë të mundur që të kemi prova shkencore për këtë ngjarje të madhe. Kjo ishte e pamundur që të njihesh shkencërisht para 1.400 vjetësh. Por, siç përmendëm në ajetin e kaluar, Allahu na e ka treguar këtë gjë porsa u shpallur për herë të parë Kur'ani.

Kjo është një mrekulli e Kur'anit dhe është njëra ndër pjesët e dëshmisë se është Fjalë e Allahut.

Orbitat

Shumë prej jush e dinë se toka jonë dhe planetet e tjera kanë orbita. Në të vërtetë, jo vetëm planetet në sistemin tonë diellor kanë orbita, por gjithashtu të gjithë trupat qiellorë në gjithësi kanë orbita të tyre të veçanta. Pra, ata të gjithë lëvizin në rrugë të llogaritur në mënyrë shumë precize. Kjo dëshmi shkencore që shkencëtarët e kanë zbuluar vetëm kohët e fundit, është shpallur para 14 shekujsh:

Ai është që krijoi natën e ditën, diellin e hënën dhe secili prej tyre noton në orbitë. (Enbija: 33)

Ai është Krijuesi i qiejve dhe i tokës! Prej nga të ketë fëmijë kur nuk ka bashkëshorte?!

*Ai krijon çdo send,
dhe Ai di çdo send.
(Sure En'am:101)*

Siç shihet nga ky ajet, Allahu na njofton për një fakt shkencor i cili është zbuluar kohët e fundit. Në kohën kur u shpall Kur'ani, njerëzit nuk e dinin se trupat qiellorë lëvizin në orbita të pandryshueshme. Por, Allahu i di të gjitha dhe Ai u tregon robërve të Vet atë që dëshiron.

Detet nuk përzihen me njëri-tjetrin


Një ndër veçoritë e deteve që është zbuluar kohët e fundit është treguar kështu në një ajet kuranor:

Ai e lejoj dy detet të puqen ndërmjet tyre. Ndërmjet atyre të dyve është një pengues që ata të dy nuk kapërcejnë. (Rahman: 19-20)

Kjo veçori e deteve, që janë afër por, prapsepapë nuk përzihen me njëri-tjetrin, është zbuluar shumë vonë nga oqeanologët. Për shkak të një force të quajtur "tension sipërfaqësor", ujërat e deteve fqinje nuk përzihen midis tyre. Kjo gjë shkaktohet nga ndryshimi i dendësisë së ujërave, kështu që tensioni sipërfaqësor pengon që ato të përzihen mes tyre, sikur të ishte një mur i hollë në mes. Ajo që spikat këtu është se, gjatë kohës kur njerëzit nuk kishin njohuri për fizikën, tensionin sipërfaqësor apo oqeanografinë, kjo e vërtetë u zbulua së pari në Kur'an.

Rrumbullakësia e tokës

Shkenca e astronomisë, në kohën kur është shpallur Kur'ani, e perceptonte ndryshe botën. Atëherë, disa njerëz besonin se toka është e rrafshët, ca të tjerë kishin teori të tjera. Por, fakti që toka është e rrumbullakët, atëherë nuk dihej. Sidoqoftë, nga Kur'ani u kuptua me



*Me thirrni ta mohoj Allahun
dhe ta adhuroj atë që nuk di
asgjë për të, ndërsa unë
ju thërras për te i
gjithëfuqishmi, mëkatfalësi!
(Sure Gafir: 42)*



anë të përngjasimit se forma e tokës është e rrumbullakët. Ajeti i mëposhtëm thotë:

**Ai krijoi qiejt e tokën me qëllim të caktuar;
Ai natën ia mbështjell ditës dhe ditën ia
mbështjell natës; ... (Zumer:5)**

Fjala arabe "tekuir" përkthehet "mbështjell" në ajetin e mësipërm. Në shqip ajo do të thotë "të hedhësh një gjë mbi një gjë tjetër" të palosur si një rrobë që shtrihet mbi tjetrën. Mbështjellja e ditës dhe natës me njëra-tjetrën mund të bëhet vetëm nëse toka është e rrumbullakët. Por, siç përmendëm më sipër, arabët para 1.400 vjetësh mendonin se toka është e rrafshët. Kjo do të thotë se rrumbullakësia e tokës ishte thënë tërthorazi në Kur'an, i cili u shpall në shek. e 7-të.

Kjo për arsye se Allahu u mëson njerëzve të vërtetën. Kjo çështje, e përmendur në Librin e shpallur nga Allahu, u vërtetua vetëm në shekujt e mëvonshëm nga shkencëtarët.

Kur'ani është fjalë e Allahut dhe në të janë përdorur fjalët më të sakta kur shpjegohet universi. Është vështirë që njeriu të dijë dhe t'i zgjedhë këto fjalë. Por, Allahu di gjithçka, Ai mund t'i bëjë këto të vërteta të vihen në shërbim të njeriut në çdo kohë që Ai dëshiron.

Gjurmët e gishtërinjve

Kur thuhet në Kur'an se është e lehtë për Allahun që ta kthejë njeriun në jetë pas vdekjes, Allahu na tërheq vëmendjen posaçërisht për gjurmët e gishtërinjve:

A mendon njeriu se nuk do t'i tubojmë eshtrat e tij? Po, do t'ia tubojmël Duke qenë se Ne jemi të zotët t'ia rikrijomë si kanë qenë edhe majat e gishtave të tij! (Kijame: 3-4)

Për të sjellë në jetë trupin e kalbur plotësisht të njeriut është gjë e lehtë për Allahun. Tani, vështroni me vëmendje gjurmët e gishtërinjve. Çdokush ka gjurma të veçanta të gishtërinjve. Nëse keni vëlla apo motër binjake, gjurmët e tij apo të saj gjithashtu janë të veçanta. Çdo njeri që jeton në këtë botë apo ka ndërruar jetë ka gjurma unike të gishtërinjve. Kjo është arsyeja pse, ato janë të veçanta sikurse edhe vetë njeriu. Allahu i Plotfuqishëm mund të na krijojë nga fillimi, deri në këto imtësi. Ndërkohë, duhet të kemi parasysh se domethënia e gjurmëve të gishtërinjve është fakti se, çdo person ka gjurmë karakteristike të tyre çka u zbulua vetëm në shek. e 19-të. Por, Allahu na ka tërhequr vëmendjen për majat e gishtërinjëve para 1400 vjetësh në Kur'an.

Në Kur'an ka edhe disa çështje të tjera të shtjelluara në mënyrë të mrekullueshme. Ne kemi përmendur vetëm disa prej tyre. Vetëm këto mjaftojnë që të bëhet e qartë se Kur'ani është Fjalë e Allahut. (Për më shumë



dije mund të shihni librin, “Mrekullitë e Kur'anit” nga Harun Jahja).

Allahu në Kur'an, na tregon për këto që vijnë:

A nuk e studiojnë ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç All-llahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie. (Nisa:82)

Siç shihet nga ajeti i mësipërm, Kur'ani sjell dije të sakta. Me përparimin e shkencës, po zbulohen gjithnjë e më tepër mrekulli të përmendura në Kur'an. Këto veçori të mrekullueshme të Kur'anit dëshmojnë se është shpallje prej Allahut. Detyra jonë është që t'i mësojmë dhe t'i praktikojmë urdhërat e Kur'anit me përpikmëri.

Allahu na urdhëron në shumë ajete që t'i përmbahemi Kur'anit. Ja tek janë disa prej tyre:

Ky është libër dobiprurës. Ne e zbritëm, pra, përmbajuni këtij, ruajuni në mënyrë që të mëshiroheni. (En'Am:155)

... Në të vërtetë këto janë këshilla. Kush dëshiron, merr mësim nga ai (nga Kur'ani). ('Abese: 11-12)





ÇFARË KARAKTERI DËSHIRON ALLAHU PËR NE?

Kur'ani, i cili është udhërrëfyes për njerëzimin, pa dyshim është Fjalë e Allahut. Ne mund të fitojmë një karakter me të cilin të fitojmë kënaqësinë e Allahut duke lexuar ajetet kuranore dhe duke i zbatuar ato. Kjo është me të vërtetë e lehtë. Por, në kundërshtim me këtë, shumica e njerëzve gabojnë duke u larguar nga vlerat, të cilat e kënaqin Allahun. Nëse një ditë, të gjithë njerëzit do të pajtoheshin me vlerat që kërkon Allahu dhe do t'i përvehtësonin ato, atëherë kjo botë do të ishte një strehë shumë më e mirë.

Tani të shohim shkurtimisht, se cilat janë këto vlera.

Të gjithë e dimë se Allahu e ka krijuar njeriun. Për këtë arsye, Allahu e di më së miri se cilat janë cilësitë e mira dhe të këqija të natyrës së tij. Dikush mund të mashtrojë dikë tjetër, por, nga Allahu,

s'mund të fshehë asgjë. Kjo sepse Allahu e di se çfarë ka në mendjen e njeriut. Prandaj, njeriu duhet të jetë gjithmonë i sinqertë dhe i ndershëm ndaj Allahut. Një ajet thotë kështu:

Thuaj: "Edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja ose e publikoni, All-llahu e di gjithçka ka në qiej e ç'ka në tokë; All-llahu është i Plotfuqishëm për çdo send. (Ali Imran:29)

Të All-llahut janë ç'ka në qiell dhe ç'ka në tokë, e për atë që e keni në shpirtin tuaj, e shfaqët haptazi ose e mbajtët fshehtë, All-llahu do t'ju marrë në përgjegjësi, e Ai ia fal atij që do dhe dënon atë që do. All-llahu ka mundësi për çdo send. (Bekare:184)

Njeriu që është i vetëdijshëm se, Allahu dëgjon çdo fjalë që ai shqipton, sheh çdo lëvizje që ai bën dhe di për çdo mendim që i sillet në kokë, kurrë nuk do të guxonte të bënte ndonjë vepër të ulët, edhe po të fshihej nga njerëzit e tjerë. Kjo do të thotë se, për të qenë vërtet të mirë, njerëzit duhet patjetër që të besojnë në qenien e Allahut dhe të njohin fuqinë e Tij dhe duhet të jenë të vetëdijshëm se Ai sheh dhe dëgjon gjithçka. Ky është themeli mbi të cilin do të ndërtohen vlerat që Allahu kërkon nga robët e Vet.

Dashuria ndaj Allahut dhe Mbështetja tek Ai

Ju digjeni për dashurinë e prindërve tuaj , apo jo? Gjithashtu edhe ju i doni ata. Ata ju duan, ju mbrojnë dhe ju plotësojnë nevojat tuaja. Nëse hasni ndonjë vështirësi, e dini se janë gjithmonë afër jush që t'ju ndihmojnë.

A keni menduar ndonjëherë sa e doni Allahun dhe sa mbështeteni tek Ai? Allahu i plotëson nevojat e të gjitha krijesave që Ai krijon. Falë mëshirës së Tij të pamatë, ne jetojmë në këtë botë në paqe dhe shijojmë të mira të panumërta.

Allahu krijoi diellin në mënyrë që ne të mund të jetojmë në tokë. Allahu, gjithashtu, krijoi perimet, pemët dhe kafshët për ne. Falë këtyre mirësive ne konsumojmë bukë, qumësht, mish si dhe fruta dhe perime të tjera të shumëllojshme dhe të shijshme, sepse Allahu i krijoi të gjitha këto për ne.

Allahu krijoi shiun në mënyrë që të kemi ujë të freskët për të pirë. Ai krijoi oqeanet, të cilat janë masa të mëdha uji të kripur. Pa shi, nuk do të kishte as ujë të ëmbël e as ujë të kripur në tokë. Uji është lëndë jetësore për ne. Siç e dini, njeriu mund të jetojë pa ujë vetëm për disa ditë. Allahu ka vendosur sistemin tonë imunitar brenda në trup për të na mbrojtur nga mikrobet. Falë sistemit tonë imunitar, ne nuk vdesim nga një mikrob i thjeshtë që shkakton një të ftohur të zakonshme. Përveç këtyre, Allahu bën që zemrat tona të rrahin pa pushim gjatë gjithë jetës. Nëse zemrave tona do t'iu duhej të pushonin për periudha të caktuara, si motorët, sigurisht që ne do të vdisnim. Por, zemrat tona rrahin pa pushim për dekada pa ndalur dhe kjo bën që ne të jetojmë.






Allahu ka krijuar sytë që të shohim, veshët për të dëgjuar, hundën për të nuhatur dhe gjuhën për të shijuar. Këto janë vetëm disa të mira që Allahu na ka dhënë. Ne nuk mund t'i llogaritim të gjitha të mirat që na ka dhuruar Allahu. Në një ajet, Allahu, që është aq i mëshirshëm për ne, na drejtohet kështu:

Dhe Ai ju dha gjithçka që e kërkuat (që kërkoi nevoja juaj) dhe, edhe në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të mirat e All-llahut nuk do të mund të arrini t'i përkufizoni (në numër). Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë përbuzës. (Ibrahim:34)

Siç kemi kuptuar nga Kur'ani, të qenit jofalenderues për të gjitha këto të mira, duke harruar se të gjitha të mirat vijnë nga Allahu dhe mos falenderimi ndaj Tij për të gjitha që Ai i ka bërë për ne, është një sjellje e papranueshme. Allahu nuk i do mosmirënjohësit. Si mirënjohje për të



*Dhe ai jua dha gjithë atë që e
kërkuat (që kërkoi nevoja juaj) dhe,
edhe në qoftë se përpiqeni ti numëroni
të mirat e Allahut, nuk do të mund ti
arrini t'i përkufizoni (në numër).
Vërtet, njeriu është i padrejtë
dhe shumë përbuzës.
(Sure Ibrahim: 34)*

mirat e Tij, Allahu kërkon vetëm që ta adhurojmë, të jemi mirënjohës ndaj Tij, domethënë ta falënderojmë. Urdhëri i Tij tregohet në këtë ajet kuranor:

All-llahu ju nxorri nga mitrat e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, në mënyrë që të jeni falënderues. (Nahl: 78)

E ju (besimtarë), hani, pra, nga të mirat që ua dha All-llahu, të lejuara e të pastra, jini mirënjohës për dhuntitë e All-llahut, nëse jeni të sinqertë në adhurim vetëm ndaj Tij. (Nahl: 114)

Ai është Ai që ua krijoi të dëgjuarit, të parit dhe të kuptuarit e juaj; sa pak jeni mirënjohës. (Mu'minun:78)

Në një ajet tjetër, tregohet për ata që kanë dashurinë më të madhe për Allahun:


E nga njerëzit ka asish që në vend të All-llahut besojnë idhujt, që i duan (i madhërojnë) ata, sikur (që besimtarët e vërtetë e duan) All-llahun, po dashuria e atyre që besuan All-llahun është shumë më e fortë. E sikur ta dinin ata që bënë mizori se kur ta shohin dënimin (në botën tjetër), do të binden se e tërë fuqia i takon vetëm All-llahut (e jo idhujve) dhe se All-llahu është ndëshkues i rreptë.

(Bekare: 165)

Allahu mbron dhe ushqen nënën tuaj, babain dhe të gjithë të tjerët. Ne të gjithë kemi



*Allahu ju nxorri nga
mitrat e nënave tuaja (si
foshnje) qe nuk dinit asgjë. Ju
pajisi me (shqisa për) të
dëgjuar, me të parë, dhe me
zemër, ashtu që të jeni
falënderues.
(Sure Nahl: 78)*



nevojë për Allahun. As prindërit tanë e as ne nuk mund t'i kishim bërë vetë këto gjëra. Për këtë arsye, duhet ta duam Allahun dhe të shpresojmë në Të.

Dashuria ndaj Allahut më shumë se ndaj çdo njeriu tjetër dhe çdo gjë tjetër, mbështetja tek Ai dhe falënderimi për gjithçka që na ka dhuruar, janë ndër vetitë më të shkëlqyera të karakterit, me të cilat Allahu është i kënaqur.

Si duhet të sillemi me njerëzit e tjerë?

Allahu i ka ndaluar njerëzit që të jenë mospërfillës, gënjeshtarë, tallës apo kryelartë. Të qenit i thjeshtë dhe i ndershëm janë tipare me të cilat kënaqet Allahu.

Njerëzit shpesh jetojnë nën ndikimin e njerëzve përreth. Nëse kanë shokë të këqinj, ata mund të ndikojnë keq tek ta. Por, një njeri që beson Allahun dhe e di se Ai vazhdimisht e vështron, kurrë nuk i shmanget veprave të mira, pa marrë parasysh se si janë kushtet. Ai bëhet shembull për njerëzit tjerë të pandershëm dhe të prirur për gjëra të këqija. Allahu i do njerëzit e palëkundur. Shprehja "qëndrueshmëri" në Kur'an nuk është e kufizuar të qenit i duruar vetëm gjatë vështirësive, por të qenit i qëndrueshëm në çdo çast të jetës. Qëndrueshmëria e besimtarit nuk ndryshon sipas njerëzve apo ngjarjeve. Për shembull, dikush që nuk i frikësohet Allahut mund të jetë i mirë ndaj dikujt, nga i cili pret që të ketë ndonjë përfitim, por nuk e shfaq këtë qëndrim në mënyrë të vazhdueshme. Kur dikush sheh se interesat e tij preken, befaz, mund të ndryshojë. Sidoqoftë, besimtari, i largohet me kujdes

sjelljes së keqe. Ai sjellet ndaj tjerëve me sjellje të shkëlqyer dhe është i bindur se duhet vepruar ashtu, pa marrë parasysh rrethanat apo qëndrimet e njerëzve tjerë. Edhe pse mund të jetë i inatosur, ai ia del që të kontrollojë vetveten dhe të tregojë qëndrueshmërinë e tij. Në një ajet, Allahu urdhëron njerëzit që të garojnë në qëndrueshmëri:

O ju besimtarë! Bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, rriini të përgatitur dhe, që të shpëtoni, ruajuni dënimin të Allahut.

(Ali Imran: 200)

Qëndrueshmëria e profetëve të përmendur në Kur'an është shembull i mirë për ne. Siç iu kujtohet, vuajtja e Ejubit, paqja qoftë mbi të, zgjati shumë. Por, ky shërbëtor bujar i Allahut tregoi qëndrueshmëri dhe iu lut Allahut. Allahu iu përgjegj lutjeve të tij dhe e çliroi.

Nuhu, paqja qoftë mbi të, shfaqti qëndrueshmërinë e tij kur e përqeshnin njerëzit kur donte ta ndërtonte anijen. Ai qëndroi i qetë dhe i këshillonte. Këto janë shembuj të jashtëzakonshëm të qëndrueshmërisë të treguar nga këta bujarë. Allahu tregon në shumë ajete se Ai i do shërbëtorët e Tij që janë të qëndrueshëm.



Përkundrazi, Allahu nuk i do arrogantët. Jo të gjithë njerëzit i gëzojnë të gjitha të mirat e kësaj bote njësoj. Disa kanë shtëpi dhe makina të bukura ndërsa të tjerët s'kanë asgjë, por ajo që ka rëndësi janë sjelljet e mira. Për shembull, duke menduar se dikush qëndron më lart se tjeri, pasi ka veshje më të bukura, është një sjellje që e zemëron Allahun. Kjo sepse Allahu na urdhëron që të çmojmë njerëzit për besimin e tyre, e jo me pamjen e jashtme.


Për Allahun, shkalla e epërsisë nuk qëndron në pasuri apo fuqi, bukuri apo forcë. Allahu i çmon njerëzit sipas frikë-respektit ndaj Allahut (takua), dashurisë që ndjejnë për Të, për besnikërinë dhe zotimin e tyre se do të jetojnë në pajtim me vlerat e Kur'anit. Këto janë kriteret për të vlerësuar lartësinë e dikuajt para Allahut. Në Kur'an, Allahu tregon rrëfimin për Karunin, si mësim për ne.

Karuni ishte një njeri shumë i pasur. Ai ishte aq i pasur sa që çelësat e pasurisë së tij mezi i mbanin disa njerëz. Injorantët vdisnin nga etja për të qenë si ai dhe ëndërronin të kishin pasuri si ai. Por, Karuni ishte një njeri arrogant dhe lavdërohej së tepërmi dhe nuk i bindej Allahut. Ai mohonte se Allahu ishte Ai që ia kishte dhuruar pasurinë e tij. Kështu që, Allahu i solli një fatkeqësi të tmerrshme Karunit: ai dhe e gjithë pasuria e tij u zhdukën për një natë të vetme. Në këtë fatkeqësi të tmerrshme, ata që dëshironin që të bëheshin si ai u gëzuan që nuk ishin në vendin e tij. Ata të gjithë e kuptuan këtë si dënim nga Allahu. Karuni rrëfehet si shembull në Kur'an kështu:

Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai shtypte atë popull sepse Ne i patëm dhënë aq shumë pasuri sa që një grup i fuqishëm mezi bartin çelësat e (pasurisë së) tij, e kur populli i vet i tha: "Mos u

kreno aq fort sepse All-llahu nuk i do të shfrenuarit!" (Kasas: 76)

Ai (Karuni) doli para popullit të vet me stolinë e vet, e ata që kishin synim jetën e kësaj bote thanë: "Ah, të kishim pasur edhe ne si i është dhënë Karunit, vërtet ai është fatbardhë!" E ata që ishin të zotët e diturisë thanë: "Të mjerët ju, shpërblimi i All-llahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepër të mirë, po atë nuk mund ta arrijë kush përveç durimtarëve!" Po Ne, atë dhe pallatin e tij i shfarosëm në tokë dhe, veç All-llahut nuk pati që ta mbrojë e as vetë nuk pati mundësi të mbrohet. E ata që dje lakmuan të ishin në vendin e tij, filluan të thonë: "A nuk shihni se All-llahu me të vërtetë i jep begati e komoditet atij që do nga robërit e vet, e edhe ia pakëson atë atij që do, e sikur All-llahu të mos derdhte mëshirë ndaj nesh, do të na sharronte në tokë edhe neve; sa habi, se si jobesimtarët nuk gjejnë shpëtim!" (Kasas: 79-82)



Karuni ishte një njeri shumë i pasur dhe mendjemadh



Si pasojë e paturpësisë kundrejt Allahut, Karuni u përpi nga toka së bashku me gjithë pasurinë e tij.

Kur'ani na njofton se “përgojimi” dhe “shpifja” janë disa vese të tjera që Allahu nuk i do. Përgjimi për gabimet e dikujt, shpifja dhe bërja e dikujt si shënjestër talljeje janë sjellje të cilave duhet t'i shmanget me çdo kusht ai që ka frikën Allahut. Në Kur'an Allahu e ndalon shpifjen dhe përgojimin. Në lidhje me këtë le të shohim vargun më poshtë :

O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, sepse disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njeri tjetrit, dhe mos përgojoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është Mëshirues, Ai pranon shumë pendimin. (Huxhurat:12)

Siç bëhet e qartë nga ajeti, Allahu na tregon në Kur'an se, shpifja është e neveritshme sikurse ngrënia e mishit të vëllait të vdekur. Allahu na tregon se si të sillemi drejt në jetën tonë të përditshme. Jeta është një mundësi e dhuruar nga Zoti ynë që të ecim rrugës së vërtetë. Sot, shumica e njerëzve janë të pavetëdijsëm për këtë. Në vend që t'u binden urdhërave dhe këshillave të Allahut, ata kërkojnë të tjerë udhërrëfyes. Duke qenë nën ndikimin e filmave që shohin apo këngëve që dëgjojnë, ata përvehtësojnë vlera të gabuara. Për shembull, të rinjtë që shohin një hero të pamëshirshëm dhe të vrazhdë në një film, zakonisht, fillojnë ta imitojnë atë menjëherë pasi dalin nga kinemaja.

Sidoqoftë, njeriu i mençur dhe i sinqertë, kurdoherë shfaq me virtyte të cilat Allahu është i kënaqur. Profetët janë njerëzit, gjurmëve të të cilëve duhet të ecim. Cilësitë që duhet të fitojmë janë ato vlera, me të cilat Allahu është i kënaqur. Këto janë për shembull: të qenit i mëshirshëm, falës, i thjeshtë, i nënshtruar, i qëndrueshëm dhe i bindur ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Dikush që përvehtëson këto vlera fisnike nuk e ul veten që të përfshihet në grindje; ai me dëshirë i zgjidh ato dhe tregon zemërgjerësi. Në vend që të jemi të vrazhdë dhe të padëgjueshëm ndaj prindërve, Kur'ani na urdhëron që të jemi të bindur dhe respektues. Në Kur'an, Allahu thekson rëndësinë e të qenit respektues ndaj prindërve tanë:

Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese). Dhe në shenjë mëshire

shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: "Zoti im! mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël".

(Isra:23-24)

Duke qenë i dëgjueshëm ndaj prindërve, duke mos treguar as shenjën më të vogël të acarimit ndaj tyre duke shfryrë "Uh" dhe duke qenë kurdoherë i mëshirshëm dhe zemërbutë ndaj tyre është një tipar i rëndësishëm i karakterit që Allahu kërkon nga ne. Duke treguar këto edhe fitojmë kënaqësinë e Allahut dhe jeta jonë bëhet më e lumtur dhe më e qetë. Njeriu mund t'i shfaqë këto cilësi të lavdëruara në Kur'an, vetëm nëse e zbaton Islamin. Jobsimtarët vështirë të përpiqen të vishen me këto tipare bujare. Ju duhet t'i largoheni sa më tepër shembullit të këtyre njerëzve dhe gjithmonë mbajeni në mendje këtë varg: **"A mos menduat ju se do të hyni në xhennet e All-llahu pa i ditur (pa u vërtetuar)**

se cilët prej jush kanë luftuar, dhe pa u ditur cilët

prej jush ishin të durueshëm." (Ali

Imran:142) Kurrë mos harroni se

Allahu do t'ju dojë më shumë dhe do

t'ju shpërblejë me më shumë të mira

kur të bëheni të duruar, të thjeshtë,

vetëflijes, zemërgjerë, dhe kur

silleni mirë.





ADHUROJENI ALLAHUN

Allahu, Krijuesi i gjithçkaje brenda dhe jashtë teje, ka fuqi të pakufishme. Zoti ynë na ka krijuar dhe na urdhëron që t'i nënshtrohemi Atij dhe të sillemi mirë, ashtu siç është përshkruar në Kur'an. Ajo që Allahu kërkon nga ne është ta adhurojmë. Agjërimi, lutja, të qënit mirënjohës ndaj Allahut, të qenit i duruar, si dhe përfshirja në punë të mira janë vetëm disa nga veprat e adhurimit.

Por, megjithëse shumica e njerëzve janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre, nuk dëshirojnë ta pranojnë këtë. Për shkak të kryelartësisë së tyre mëkatore e kanë shumë të vështirë t'i nënshtrohen Allahut. Ata nuk dëshirojnë t'i dëgjojnë fjalët e Allahut pasi iu duket vetja shumë të rëndësishëm. Duke refuzuar Allahun si Krijues, ata guxojnë t'i kundërvihen Atij. Ndonëse Allahu u ka dhënë atyre zemrën, veshët, shëndetin, shkurtimisht, çdogjë në këtë botë, ata nuk i janë mirënjohës Atij për të gjitha këto të mira.

Por, këta njerëz do të pendohen shumë. Të qenit mosmirënjohës dhe rebelë do t'iu kushtojë një jetë të dëshpëruar, me probleme të vazhdueshme në këtë botë dhe pendim të thellë në botën tjetër. Mosmirënjohja (kufri) që ata shfaqin në këtë botë do t'i shpjerë në zjarrin e Xhehenemit.

Çdokush që nuk dëshiron që të përjetojë pendimin dhe të bëhet njëri prej atyre që do të hyjnë në zjarr, duhet që t'i jetë mirënjohës Allahut. Allahu dëshiron nga ne që të jemi mirënjohës ndaj Tij dhe t'i lutemi e të adhurojmë vetëm Atë si mirënjohje për të gjitha të mirat që Ai na i ka dhuruar. Ndaj, kur të vështroni mirësi të përsosura dhe këto bukuri që ju rrethojnë, të cilat nuk janë krijuar vetvetiu, duhet ta përkujtoni Allahun dhe të falenderoni Atë. Mos u bëni prej atyre që nuk i vërejnë dhe as nuk i çmojnë këto të mira. Në Kur'an, Allahu na urdhëron që të praktikojmë edhe forma të tjera adhurimi përveç mirënjohjes ndaj Tij. Falja pesë herë në ditë, agjërimi gjatë muajit Ramazan, dhënia e zekatit (apo taksa e pasurisë) si dhe shkuarja në haxhxh, (peligrinazhi në Mekë së paku një herë gjatë







jetës) nëse keni mundësi, janë format e tjera të adhurimit që Allahu kërkon nga ne.

Të falurit pesë herë gjatë ditës dhe vendosja e rregullit të të falurit në jetën tonë të përditshme, në familje dhe bashkësitë tona na ndihmon që të sjellim në mend dobësitë tona si shërbëtorë para Allahut. Ajo është një vepër adhurimi që duhet të kryhet në kohë të caktuara. Allahu na njofton në Kur'an se ky lloj adhurimi na ndihmon që të përmbahemi nga veprat e këqija, me të cilat Allahu zemërohet .

Agjërimi është gjithashtu një formë e adhurimit e urdhëruar në Kur'an. Gjatë muajit të Ramazanit, Allahu kërkon nga ne që mos të hamë dhe mos të pimë gjatë ditës. Duke plotësuar këtë formë adhurimi, ne shfaqim durimin tonë duke qëndruar për një kohë të caktuar pa ujë dhe pa ushqim.

Nga ana tjetër, është dhënia e zekatit, që është ndarja e një pjese nga pasuria nevojtarëve dhe të varfërve si dhe të tjerëve që e marrin atë. Ashtu si format e tjera të adhurimit, plotësimi i saj është shumë i rëndësishëm, sepse largohemi nga kopracia dhe shfaqim vetëflijm, të cilat janë tipare me



të cilat fitohet kënaqësia e Allahut. Përveç kësaj, duke paguar zekatin përmirësohet bashkëpunimi mes njerëzve dhe shpirti i njeriut fisnikërohet.

Lutja është mënyrë që t'i afrohemi Allahut

Allahu i jep rëndësi të madhe lutjes. Ai tregon për rëndësinë e lutjes në ajetin në vijim: **"Thuaj: "Zoti im as nuk do të kujdesej për ju, sikur të mos ishte lutja juaj (kur gjendeni në vështirësi, ose sikur të mos ishit të thirur të besoni)..."** (Furkan:77) Siç tregojnë këto ajete, vlera e njeriut para Allahut varet nga lutja e tij. Kjo, pasi njeriu i cili falet lutet për atë dhe e kërkon atë vetëm nga Allahu. Allahu është Pronari i gjithçkaje. Allahu krijon çdo gjë për diçka cilën kemi nevojë. Të marrim për shembull, ushqimin që është thelbësor për jetën e njeriut. Allahu krijoi perimet, pemët, zogjtë, pulat, lopët etj. Allahu krijoi prindërit tuaj dhe të gjithë njerëzit tjerë përreth. Allahu, i Plotfuqishëm, i pajisi njerëzit me trup, mendje, dituri, fuqi, shëndet dhe mirësitë që ata i gëzojnë.

Siç thamë më lart, Allahu i krijoi të gjitha këto të mira për ne. Ushqimin që hamë, e kemi prej Allahut. Ngjashëm, prej Allahut kemi edhe aftësinë për të ngrënë. Mendoni pak! Si do të kishit mundur të përtypni ushqimin pa dhëmbë? Si do ta tretnit atë në stomak? Çfarë rëndësie do të kishte prania e ushqimit nëse nuk do të kishim sistemin tretës?

Ju ushqeheni në sajë të vullnetit të Allahut. Allahu është Ai, i Cili na



i ka dhuruar gjithë këto të mira, prandaj Atij duhet t'i lutemi nëse dëshirojmë të ndodhë diçka apo të fitojmë diçka tjetër. Për këtë arsye, gjithçka duhet ta kërkojmë nga Zoti ynë.

Një shembull do ta sqarojë më mirë këtë: Ju shkelni çelësin për të ndezur dritën. A mund të thoni se çelësi e prodhon dritën? Natyrisht që jo. Ai është vetëm një mjet, ashtu si kabllot që përçojnë rrymën elektrike. Në këtë botë, Allahu ka krijuar shkakun për çdo pasojë. Ai krijoi ujin. Nga digat ky ujë kalon nëpër turbinat e mëdha, dhe në këtë mënyrë prodhohet energjia elektrike. Kabllot transmetojnë elektricitetin dhe përfundimisht llamba elektrike e transformon rrymën elektrike në dritë. Por, e vërteta është se Allahu e ka krijuar dritën. Nëse Allahu dëshiron, Ai mund ta kishte krijuar rrymën elektrike pa këto shkaqe.



Por, Zoti ynë dëshiron që ne të përdorim mendjen tonë, të mendojmë, të vrasim mendjen për ato që ka krijuar Allahu, dhe në këtë mënyrë të arrijmë tek besimi.

Që të marrim ujë nga çezma duhet të hapim rubinetin. Por, a mund të thoni se tubat apo rubineti e krijon ujin? Si në rasin e çelësit, rubineti është vetëm një mjet, por jo edhe shkak. Ky është këndvështrimi që duhet përvehtësuar dhe ky gjithashtu shpjegon pse duhet t'i lutemi Allahut, pasi Allahu ka krijuar çdo gjë. Me miliona vëllime librash do të mbusheshin me listën e arsyeve pse duhet falenderuar Allahu dhe pse duhet t'i lutemi Atij. Prandaj, prania e njerëzve të shumtë rreth jush, të cilët nuk i kushtojnë rëndësi aq të madhe këtyre çështjeve, nuk duhet t'ua ndërrojë mendjen juve. Dështimi i tyre për të vënë në punë mendjen e tyre dhe mungesa e të menduarit dhe meditimit i ka tërhequr

ata në një gabim të madh.

Allahu na njofton për fundin që i pret këta njerëz. Shpërblimi apo dënimi ynë në jetën tjetër varet nga sjellja jonë në këtë botë dhe sa jemi përpjekur që t'i afrohem Allahu. Çdo njeri do të shpaguehet në jetën e përtejme për atë çfarë ka punuar.

Si mund të lutemi?

Çështje thelbësore për lutjen janë: pasja në mend e fuqisë dhe madhësisë së Allahut, frikë-respekti ndaj Tij, përlësia dhe veçimi nga njerëzit. Allahu na njofton në Kur'an se si duhet të lutemi:

Luteni Zotin tuaj të përlur e në heshtje, sepse Ai nuk i do ata që e teprojnë. (A'raf:55)

Lutja nuk është e kufizuar në kohë apo vend. Mund të kujtojmë Allahun dhe t'i lutemi Atij në çdo çast. Allahu na urdhëron në Kur'an kështu:





Për ata që All-llahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! (Ali Imran: 191)

Pra ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj juve (me shpërblim). Më falënderoni e mos Më mohoni. O ju që keni besuar, kërkoni ndihmë me durim e me të falur, se vërtetë All-llahu është me durimtarët. (Bekare:152-153)

Allahu na jep në Kur'an shembuj të ndryshëm për mënyrën e lutjes. Ja disa prej lutjeve të profetëve dhe besimtarëve:

Nuhu tha: "Zoti im, unë mbështetem në mbrojtjen Tënde që të (mos) kërktoj prej Teje atë për çka nuk kam njohuri, e në qoftë se nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron Ti, do të jem i humbur!" (Hud: 47)

Edhe kur Ibrahim dhe Ismaili, duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabes - luteshin): "Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!" Zoti ynë, bëna neve të dy besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tonë dhe falna neve, vërtetë Ti je që fal, je

Mëshirues!" Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre të dërguar që t'u lexojë atyre ajetet e Tua, t'u mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t'i pastrojë (prej ndytësisë së idhujtarisë) ata. S'ka dyshim se Ti je Ngadhënjyesi, i Dijshmi. (Bekare: 127-129)

(Pasi iu plotësua dëshira Jusufi tha:) Zoti im, Ti më ke dhënë mua pushtet, më mësove mua komentimin e ëndrrave; o Krijues i qiejve e i tokës, Ti je kujdestari im në dynja e në ahiret, më bën të vdes musliman dhe më bashko me të mirët!" (Jusuf: 101)

E ai (Sulejmani) buzëqeshi i gëzuar prej fjalës së tij dhe tha: "Zoti im, më mundëso që të të falënderoj për të mirat e Tua që m'i dhurove mua dhe prindërve të mi dhe të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen, e me mëshirën Tënde më shpier në mesin e robërve të Tu të mirët!" (Neml: 19)

Thuaj: "O Allhlah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do dhe e përul atë që do, e lartëson atë që do. Çdo e mirë është në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!" (Ali Imran: 26)

Ai (Musai) tha: "Ma zgjero (më ndihmo) gjoksin tim! Dhe më lehtëso në këtë punë timen! Më zgjidh nyjen e gjuhës sime! Që ta kuptojnë fjalën time! Më cakto një ndihmëtar nga familja ime, Harunin, vëllain tim, Që me të të ma forcosh fuqinë time, Bëma shok në punën time, Në mënyrë që të të madhërojmë Ty më shumë, dhe të të përkujojme Ty shpesh. Vërtet, Ti je Ai që na sheh dhe na i di punët". (Ta Ha: 25-35)

Për ata që Allhlahun e përmendin me përkujtimit kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! Zoti ynë, atë Ti që







e fute në zjarr, atë e ke poshtëruar; për mizorët nuk ka ndihmëtar!
Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte):
Të besoni Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti ynë, na i falë mëkatet tona,
na i mbulo të metat dhe pas vdekjes na bashko me të mirët! Zoti
ynë, jepna atë që nëpërmjet të dërguarëve Tu, na e premtove dhe
në ditën e kijametit mos na turpëro; vërtet Ti je Ai që nuk e shkel
premtimin!" Zoti i tyre iu përgjegj lutjes së tyre (e tha): Unë nuk ia
humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni
njëri nga tjetri, por, ata që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe
emigruan, u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u
vranë, atyre patjetër do t'ua shlyej mëkatet e tyre dhe do t'i vendos
në xhennete në të cilët burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga ana
e All-llahut, se më i miri i shpërblimeve është tek All-llahu. (Ali Imran:
191-195)

VDEKJA DHE JETA NË BOTËN E PËRTEJME

Disa njerëz vdekjen e konsiderojnë si fund përfundimtar. Por, e vërteta është se vdekja është vetëm një formë e ndërmjetme nga jeta e kësaj bote në botën tjetër. Ajo është si një portë për jetën e përtejme. Nga ana tjetër e kësaj porte, është jeta e botës së përtejme. Nëse do të shpërblehemi me jetë në Parajsë apo do të dënohemi me Zjarr, varet krejtësisht nga besimi në njëshmërinë e Allahut dhe miratimin e Allahut për veprat dhe sjelljet tona në këtë botë.

Vdekja është vetëm një fund për një kohë të caktuar. Është e ngjashme me rënien e ziles në shkollë që tregon se ka përfunduar provimi. Allahu, çdo njeriu i ka dhënë një kohë të ndryshme provimi. Disa njerëz jetojnë vetëm 30 vjet, ndërsa disa të tjerë gëzojnë jetë të gjatë deri në 100 vjet e më tepër. Ashtu siç Allahu ka përcaktuar datën e lindjes, që është fillimi i provimit tënd, Allahu vendos edhe për kohën se kur do të përfundojë kjo periudhë. Me fjalë të tjera, vetëm Allahu e di se në çfarë moshe do të vdisni.

Si duhet ta mendojmë vdekjen?

Vdekja, që është fundi i periudhës së provimit për këtë botë, është burim i lumturisë dhe i kënaqësisë për besimtarin. Ne zor se do të ndjenim keqardhje për dikë që e ka kryer provimin me sukses, apo jo?

Pikëllimi për dikë që vdes është gati qesharak. Është e vërtetë që ju

mund të humbni dikë që e keni të afërm apo dikë që e doni, por besimtari e di se vdekja nuk është ndarje e përhershme dhe se ai që vdes vetëm ka kryer periudhën e vet të provimit. Ai e di se në botën e përtejme, Allahu do t'i bashkojë muslimanët që jetojnë sipas urdhërave të Tij dhe do t'i shpërblejë ata me Parajsë. Në këtë rast, njerëzit në vend që të ndiejnë pikëllim, do të duhej që të ndihen shumë të lumtur. Allahu mund të na e marrë shpirtin në çdo çast. Prandaj, ne duhet që të përpiqemi të fitojmë kënaqësinë e Allahut.

Si përfundim, mund të thuhet se vdekja nuk është një përfundim, por, është vetëm një derë nga ku kalohet në botën e përtejme. Jeta tjetër është jeta e vërtetë dhe do të zgjasë deri në përjetësi, kështu që duhet të përgatitemi për të. A mendon se njeriu që hyn në provim dëshiron që ky provim të zgjasë pa mbarim? Natyrisht që jo. Ai dëshiron vetëm që të përgjigjet saktësisht pyetjeve dhe të largohet nga klasa. Në këtë botë, njeriu duhet të përpiqet që ta kalojë provimin, të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe të shpërblehet me Parajsë. Synimi kryesor i njeriut në të duhet që të jetë dashuria ndaj Allahut dhe fitimi i kënaqësisë së Tij. Kjo për arsyen se Zoti ynë, i Gjithmëshirshëm, na do dhe na mbron në çdo çast. Një varg kuranor, citon fjalët e njërit prej profetëve:

"...Vërtet, Zoti im është përcjellës (ruajtës) i çdo sendi". (Sure Hud:57)

Bota e Përtejme

Allahu e përshkruan natyrën e përkohshme të kësaj bote në shumë vargje kuranore dhe thekson se vendbanimi i vërtetë i njeriut është bota

e përtejme. Njeriu, i cili është sprovuar në këtë botë, një ditë do të merret nga vdekja dhe në këtë mënyrë do të fillojë jetën në botën tjetër. Ajo jetë është e pafundme. Në jetën e tij të përjetshme, shpirti i njeriut nuk zhduket. Allahu ka krijuar të mira të panumërta në këtë botë. Ai krijoi jetën në këtë botë për të parë se si do të sillemi në këmbim për këto të mira që gëzojmë. Si shpërblim dhe dënim Allahu ka krijuar gjithashtu Parajsën dhe Zjarrin. Allahu na tregon se si njeriu do të shpaguehet në praninë e Tij në jetën e përtejme:

Kush vjen me një (punë) të mirë, ai (në ditën e gjykimit) shpërblehet dhjetë fish, e kush vjen me (vepër) të keqe, ai ndëshkohet vetëm për të. Atyre nuk u bëhet e padrejtë. (Enam: 160)

Allahu është shumë i mëshirshëm ndaj njerëzve. Ai i shpërblen ata me bujari. Por, ata që meritojnë dënimin do të dënohen vetëm sa për veprat e tyre të këqija. Allahu nuk i bën padrejtë askujt. Njerëzit mund t'i trajtojnë të tjerët me padrejtësi. Në këtë botë, fajtori mund t'i mashtrojë tjerët, por, në botën tjetër, nëse nuk beson në Allahun dhe njëshmërinë e Tij, sigurisht që Allahu do ta dënojë. Nëse është musliman, Allahu atëherë mund ta dënojë apo ta falë. Allahu sheh dhe di gjithçka dhe në këtë mënyrë shpagueu çdo vepër.

Parajsa dhe Zjarri

Parajsa dhe Zjarri janë dy vende të ndara ku njerëzit do të kalojnë jetën e tyre pas vdekjes. Përsëri, Kur'ani na sjell dije të saktë për këto vende.

Ju mund të keni qenë në vende me peizazhe të bukura apo mund

të keni parë nëpër filma pamje të mahnitshme. Apo mund të ketë vende prej të cilat nuk do të dëshironit të largoheshit asnjëherë. Parajsa është pakrahasueshmërisht më e bukur se këto vende. Ushqimi që do të shijojnë besimtarët në të është shumë më i shijshëm sesa ushqimi në këtë botë.

Allahu, Krijuesi i të gjitha bukurive në botë, na thotë se Ai ka krijuar bukuri edhe më të mrekullueshme në Parajsë për besimtarët e sinqertë.

Telashet e kësaj bote na bëjnë të kuptojmë më mirë bukurinë e xhennetit

Ne përjetojmë shqetësime të ndryshme në këtë botë. Sëmuremi, mund të thyejmë ndonjë dorë apo këmbë, kemi të ftohtë apo të nxehtë, na dhemb barku, lëkura na dëmtohet, etj. Shihni fotot e prindërve tuaj kur kanë qenë të rinj dhe vëreni tani fytyrat e tyre. Do të dalloni shumë lehtë ndryshimin. Allahu e ka krijuar qëllimisht një dobësi të tillë për njeriun në këtë botë. Sapo na kaplon dobësia, ne mund ta çmojmë më tepër vlerën e xhennetit. Hyrja në Parajsë i zhdruk të gjitha telashet. Vetëm mendoni për të gjitha pakënaqësitë e kësaj bote... Asnjëra prej tyre nuk ekziston në botën tjetër.

Parajsa është e zbukuruar me të mira prej të cilave njeriu ndjen kënaqësi të papërshkrueshme. Gjërat më të mira që ne mund t'i hamë dhe pimë në këtë botë mund t'i gjejmë të përsosurura në Parajsë. Njeriu kurrë nuk ndien të ftohtë apo të nxehtë në të. Ai kurrë nuk sëmuret, frikësohet, hidhërohet apo plaket. Nuk mund të gjesh asnjë njeri të keq

atje. Kjo për arsye se njerëzit e këqinj, ata të cilët nuk e besuan Allahun dhe e mohuan Atë, do të mbeten në Zjarr, një vend që ata e meritojnë. Njerëzit në Parajsë flasin hirshëm me njëri-tjetrin; ata atje nuk mallkojnë, nuk inatosen, nuk bërtasin dhe nuk lëndojnë të tjerët. Të gjithë njerëzit e mirë, të cilët kanë besim të shëndoshë në njëshmërinë e Allahut dhe sillen në atë mënyrë që e kënaqin Atë, do të qëndrojnë atje si miq përgjithmonë sepse e kanë merituar.

Nga Kur'anit mësojmë se në Parajsë ka gjëra të mrekullueshme: shtëpi madhështore, kopshte me hije dhe lumenj të rrjedhshëm që ia shtojnë kënaqësinë e banorëve të tij. Në të vërtetë, ato që përvijuan më lart janë të pamjaftueshme për të përshkruar të gjitha të mirat e Parajsës. Bukuria e saj i kapërcen kufijtë e imagjinatës. Në Kur'an, Allahu na njofton se në Parajsë, njeriu do të fitojë më shumë sesa pret. Imagjino se dëshironi të keni diçka apo të shkoni diku. Me vullnetin e Allahut, do t'i keni sa hap e mbyll sytë. Në një ajet Allahu thotë kështu:

... Ju do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkonit. (Fussilet: 31)

Ja disa nga ajetet kuranore që tregojnë bukurinë e Xhennetit: Shembulli i Xhennetit, i cili u është premtuar atyre që janë ruajtur (të devotshëm) në të cilin ka lumenj me ujë për pije, lumenj nga qumështi me shije të paprishur, lumenj nga vera e shijshme për njerëz, lumenj nga mjalti i kulluar, ata kanë aty edhe gjithfarë lloj pemësh, kanë edhe falje nga Zoti i tyre (a është i njëjtë) a si ai që është përgjithmonë në zjarr dhe u shuhet etja me ujë të valë që ua copëton zorrët e tyre? (Muhammed:15)


E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre do t'u bëjmë vend të lartë në Xhennet në të cilin rrjedhin lumenj, aty janë përgjithmonë; sa i mirë është shpërblimi për ata që vepruan. (Ankebut:58)


*Ata që besuan dhe bënë
vepra të mira, e Ne as që
obligojmë ndokënd çka nuk ka
mundësi (të veprojë), të tillët
janë banues të xhenetit dhe në
të janë përgjithmonë.
(Sure A'raf: 42)*






*E ata që besuan dhe bënë
vepra të mira, atyre do tu bëjmë
vend të lartë në xhenet në të cilin
rrjedhin lumenj, ata janë
përgjithmonë, sa i mirë është
shpërblimi për atë që vepruan.
(Sure Ankebut: 58)*









*(u thonë) Ne kujdesemi
për ju, si në jetën e kësaj bote,
ashtu edhe në botën tjetër, ku
do të keni atë që dëshironi dhe
gjithçka kërkon.
(Sure Fussilet: 31)*

*Janë nën drunj e pemë pa therra
(pa gjemba). Të bananeve me fruta
palë palë. Nën hije të përherhme.*

Pranë ujit rrjedhës.

Edhe ndër pemë shumë llojesh.

*Që as nuk ndërprehen as nuk
janë të ndaluara.*

(Sure Vakia: 28-33)





Xhennetet e Adnit janë që do të hyjnë në to, aty do të stolisen me rrethdorëza nga ari e margaritari, e petkat e tyre janë të mëndafshita. (Fatir: 33)

Ata të Xhennetit tash janë të angazhuar me kënaqësi. Ata dhe shoqet e tyre janë nën hijet të mbështetur në kolltukë. Aty kanë pemë dhe çka të duan. (Ja Sin: 55-57)

Janë nën drunj të pemëve pa therra (pa gjemba). Të bananeve me fruta palë-palë. Nën hije të përhershme. Pranë ujit rrjedhës. Edhe ndër pemë shumë llojesh. Që as nuk ndërprehen, as nuk janë të ndaluara. Edhe shtretër të lartë (ose gra të larta). (Uakia: 28-34)

Allahu gjithashtu na tregon se njerëzit që meritojnë Parajsën do të qëndrojnë aty përgjithmonë:

Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, e Ne as që obligojmë ndokënd çka nuk ka mundësi (të veprojnë), të fillët janë banues të Xhennetit dhe në të janë përgjithmonë. (A'raf: 42)

Besimtari ngazëllet kur fiton kënaqësinë e Allahut. Kjo ndjenjë është kënaqësia më e madhe që mund të përjetojmë në këtë botë.

Dënimi në Zjarr do të zgjasë përjetësisht

Njerëzit që kundërshtuan Allahun dhe refuzuan të pranojnë qenien e Tij, po ashtu, do të shpaguhën për atë që kanë punuar. Ata nuk e pranuan Allahun dhe nuk besuan se Ai është Një, i Cili krijon çdo gjë, dhe u treguan arrogantë, nuk kryen veprat e adhurimit që pritej prej tyre dhe në këtë mënyrë ngritën krye në këtë botë. Si ndëshkim për këtë, ata do të dënohen në Zjarr.

Disa njerëz kryejnë krime të ndryshme në këtë botë. Në rastet kur nuk i sheh askush, ata mund të mbeten të padënuar. Por, këta njerëz nuk e dinë se Allahu i sheh ata çdo moment dhe se Ai i di edhe mendimet e tyre të fshehura.

Çdokush do të shpërblehet sipas veprave të mira ose të këqija. Allahu ka drejtësi të pamatë dhe në ajetet kuranore Ai na përgëzon se veprat e mira, sado të vogla qofshin, do të shpërblehen me bollëk. Allahu na mëson se njerëzit do të shpërblehen edhe nëse pendohen dhe i kërkojnë falje Atij. Allahu i paralajmëron njerëzit që nuk e besojnë Atë, që nuk pajtohen me urdhërat e skalitura në Kur'an dhe mendojnë se nuk ka jetë pas vdekjes.

Zjarri është shpërblimi për mëkatarët dhe për ata që ngritën krye duke kundërshtuar Allahun. Allahu shpjegon gjendjen e këtyre njerëzve në Kur'an kështu:

Ata që fenë e tyre e morrën tallje e lojë dhe të cilët i mashtroi jeta e dynjasë. Sot, pra, Ne i harrojmë ata sikurse e patën harruar takimin e kësaj dite dhe sikurse i hidhnin poshtë argumentet Tona!" (A'raf: 51)

Një dënim i dhimbshëm, që nuk krahasohet me asnjë dhimbje të kësaj bote, i pret të gjithë njerëzit e Zjarrit. Ai është një vend i mbushur me frikë, dhimbje, dëshpërim dhe vuajtje. Njerëzit në të i luten Allahut dhe kërkojnë të largohen prej tij. Por pasi kanë hyrë në Zjarr, është shumë vonë për pendim. Përmendëm më parë pendimin e Faraonit. Allahu i jep shumë mundësi njeriut deri në çastin e vdekjes. Por, pendimi nuk ka më vlerë pas vdekjes.

Njerëzit e xhehennemit jetojnë përjetësisht një jetë më të keqe se kafshët. I vetmi ushqim që ata hanë janë frutet e gjembave të hidhur të drurit të quajtur Zekum. Pijet e tyre janë gjaku dhe qelbi. Me lëkurë të çarë, me mish të djegur, dhe me gjakun e shpërndarë në të gjitha anët, ata jetojnë një jetë mizore. Me duar të lidhura për qafe, hidhen në mes të zjarrit. Përveç kësaj, kjo jetë zgjat deri në amshim.

Shumë njerëz besojnë se Zjarri është një vend i përkohshëm, se pasi të dënohen për veprat e këqija, do të dërgohen në Parajsë. Gjykimi për këtë i përket Allahut, i Cili na e tregon këtë në Kur'an:

Kundër tyre është zjarri i mbyllur. (Beled: 20)

E atë (e bënin) ngase ata thonin: "Neve nuk do të na djegë zjarri vetëm për pak ditë të numëruara", e ajo që shpifën për fenë e tyre, i mashtroi keq. (Ali Imran: 24)

Sidoqoftë, ajo që duhet të bëjë një musliman që i njeh gabimet e veta dhe veprat e këqija është që të pendohet, të falet dhe të kërkojë falje nga Allahu. Në Kur'an, Allahu na informon se Ai do të na falë për çdo vepër të keqe, vetëm nëse pendimi ynë është i sinqertë. Ajeti përkatës na tregon:

Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut, pse All-llahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë fal dhe është mëshirues!" (Zumer: 53)

Për njeriun është e rëndësishme t'i pranojë gabimet e veta dhe të kërkojë nga Allahu falje për to në mënyrë që t'i shmangët pendimit të përjetshëm në jetën e përtejme dhe të shpëtojë vetveten nga vuajtjet e padurueshme në Zjarr.

PËRFUNDIM

Të dashur fëmijë! Në këtë libër shqyrtuam të vërtetat më themelore dhe më të rëndësishme për jetën tonë. Në të ngritëm pyetje të tilla si: Cili është qëllimi i jetës sonë? Si kërkon, Zoti ynë që të sillemi? Cilat janë përgjegjësitë që kemi ndaj Krijuesit tonë? Si është jeta në botën tjetër? Pse duhet të kemi frikë nga dënimi në Zjarr, etj.

Shpresojmë se do të mendoni me kujdes në lidhje me këto pyetje. Tani ju jeni ende të rinj, por, kurrë mos harroni se një ditë do të jeni pleq apo plaka.

Përreth jush mund të ketë njerëz që mund t'ju thonë se jeni shumë të vegjël për të menduar për vdekjen. Por, megjithatë ju duhet të keni



parasysh se askush nuk e di kur do të vijë ajo. Mund të vdisni pas disa ditësh apo pas dhjetë vjetësh. Kur të mendoni për të gjitha këto, do ta kuptoni menjëherë se sa gjë e pakuptimtë është humbja e kohës.

Ju tani mund të gjeni justifikime për çdo gjë.

Madje mund t'ua mbushni mendjen edhe të tjerëve. Por, në jetën e përtejme, që fillon menjëherë pas vdekjes, nuk do të mund të shpikni më asnjë arsyetim për gabimet dhe veprat e këqija të bëra në praninë e Allahut, i Cili di dhe sheh gjithçka.

Për këtë arsye, duhet të mendoheni thellë për këto të vërteta pa humbur kohë dhe duhet të përpiqeni të bëheni njerëz që i do Allahu.

*Engjëjt thanë: “Lavdia të qoftë Ty
Zoti ynë. Ne nuk kemi dije tjetër
përveç asaj që na dhurove. Ti je i
Gjithëdijshti, i Urti.”
(Bekare:32)*